



Mbrojtja

Viti i 89-të i botimit
Shtator 2021/ Nr. 9



Kongresmeni Mike Quigley
Ministri Peleshi: Angazhimi i
Shqipërisë përkrah SHBA dhe aleancës
së NATO është i padiskutueshëm



Kryesimi i Sekretariatit të SEDM-it
Bici: Shqipëria do të
vazhdojë me të njëjtin
ritëm të mbështesë SEDM



Ministri i Mbrojtjes i Kosovës vizitë në Tiranë
Peleshi: Investime
të përbashkëta
në fushën e Mbrojtjes



MENAXHIMI I ZJARREVE NË TË GJITHË TERRITORIN E VENDIT

**Rama dhe Peleshi vlerësojnë punën e
forcave të angazhuara dhe Mbrojtjes Civile**

Përmbajtja

Numri 9

EMERGJENCAT

- 6** Ministri Peleshi falënderon BE- në, Holandën dhe Çekinë për mbështetjen

BAZA AJRORE E NATO-s NË KUÇOVË

- 12** Bashkëpunimi është alternativë që garanton suksese

DY MJEKET E REJA USHTARAKE

- 19** Sfidat, vështirësitë, përgjegjësitë dhe triumfi i ëndrrës

NATO NË AFGANISTAN

- 40** Stoltenberg: Evakuimi i mbi 100,000 njerëzve operacion historik nën presion ekstrem

"TI SHQPËRI MË JEP NDER!"

- 46** Rilindasi Naim Frashëri nguliti tek shqiptarët dashurinë për Atdheun

STAFI

ANJEZA MUSOLLARI
Shef i Sektorit të Botimeve
& Kryeredaktor

Gazetarë:
Mimoza GOLIKJA
Hajrie DEDAJ

Graphic Designer:
Afërdita HYSAJ

Redaktore/ korrektore:
Suela HODA



4 MENAXHIMI I ZJARREVE

Rama dhe Peleshi vlerësojnë punën e forcave të angazhuara dhe Mbrojtjes Civile

Nga Baza Ajrore e Farkës, kryeministri Edi Rama dhe ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, shprehën mirënjohjen për të gjithë efektivet e Forcave të Armatosura, forcat...



10 KONGRESMENI MIKE QUIGLEY

Ministri Peleshi: Angazhimi i Shqipërisë përkrah SHBA dhe aleancës së NATO është i padiskutueshëm

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, priti në takim kongresmenin amerikan Mike Quigley në 19 gusht 2021. Kongresmenin Quigley shoqërohej nga...



14 KRYESIMI I SEKRETARIATIT TË SEDM-it

Bici: Shqipëria do të vazhdojë me të njëjtin ritëm të mbështesë SEDM

Shqipëria ka përmbyllur zyrtarisht kryesimin e Sekretariatit të Iniciativës së Ministrave të Mbrojtjes të Evropës Juglindore (South-Eastern Europe Defence Ministerial - SEDM), pas një...



25 AKADEMIJA USHTARAKE

Smaçi: Jemi në fazën më të mirë të transformimit të arsimit ushtarak në veçanti në nivel universitar

Znj. Smaçi, arsimimi ushtarak në Shqipëri është një shtyllë e rëndësishme në edukimin kombëtar. Që nga shkolla e parë, e cila u hap për...

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

Mbrojtja



REVISTA MBROJTJA

Organ Qendror
i Ministrisë së Mbrojtjes
Viti i 89-të i botimit
Nr. 9/ 2021

© Ministria e Mbrojtjes

Materialet e publikuara në këtë
revistë nuk mund të riprodhohen
elektronikisht apo fizikisht e të
përdoren për qëllime përfitimi, pa
marrë autorizim nga botuesit e saj.

Botues:

Qendra e Kulturës, Medias,
Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut
Drejtoria e Kulturës, Medias dhe
Botimeve të Mbrojtjes

Adresa:

Rruga e Dibrës/ Garnizoni “Skënderbej”

Revista mund të gjendet në formatin elek-
tronik (pdf) në adresën:

[http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/
publikime/revista-mbrojtja](http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikime/revista-mbrojtja)



Menaxhimi i zjarreve në të gjithë territorin e vendit

Rama dhe Peleshi vlerësojnë punën e forcave të angazhuara dhe Mbrojtjes Civile

Në 389 vatra të zjarrit u angazhuan 4960 trupa dhe 152 mjete të FA, 3309 trupa dhe 113 mjete zjarrfikëse. 1914 forca lokale të të gjitha bashkive, 1400 forca vullnetare, 489 forca të Policisë së Shtetit, 606 forcat e Shërbimit Pyjor dhe e gjithë administrata e Mbrojtjes Civile

Nga Baza Ajrore e Farkës, kryeministri Edi Rama dhe ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, shprehën mirënjohjen për të gjithë efektivet e Forcave të Armatosura, forcat zjarrfikëse, policore e bashkiake, por edhe ata vullnetarë, forca të shërbimit pyjor e të zonave të mbrojtura që u angazhuan për shuarjen e zjarreve në të gjithë territorin e vendit, gjatë muajit gusht.

Në aktivitetin e zhvilluar në 3 shtator 2021, ku morën pjesë shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj, drejtori i Agjencisë së Mbrojtjes Civile Haki Çako, ambasadori i Bashkimit Evropian Luigi Soreca si dhe zëvendësambasadori i SHBA Demian Smith, kryeministri Rama falënderoi SHBA dhe partnerët e BE, Holandën dhe Çekinë që përmes Mekanizmit të Mbrojtjes Civile kontribuan në normalizimin e situatës.

Kryeministri Rama vuri theksin tek rëndësia që ka vijimi i procesit të modernizimit të Mbrojtjes Civile, i cili tashmë ka dhënë rezultatet e para të prekshme. Po ashtu kryeministri garantoj se qeveria do të bëjë atë që duhet për të rritur pagën për trupat që përballen me sfida që kërcënojnë jetën. Kreu i qeverisë theksoi se për zjarrvënësit duhet të jepen dënimet maksimale.

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi teksa shprehu ngushëllimet për dy qytetarët që humbën jetën si pasojë e zjarreve tha se "për shuarjen e flakëve u angazhuan 4960 trupa dhe 152 mjete të FA, 3309 trupa dhe 113 mjete zjarrfikëse. 1914



forca lokale të të gjitha bashkive, 1400 forca vullnetare, 489 forca të Policisë së Shtetit, 606 forcat e Shërbimit Pyjor dhe e gjithë administrata e Mbrojtjes Civile. Kjo ishte fuqia njerëzore dhe motorike e operacioneve nga toka për të luftuar me 389 vatra të zjarrit në të gjithë vendit në harkun e dy muajve.

Ndërkohë për ndihmën nga ajri, iu bashkuan forcës sonë tre mjete helikopterë nga Holanda, 2 mjete nga Çekia". Ministri i Mbrojtjes evidentoi mbështetjen e vyer të ofruar nga SHBA, me ekspertët që asistuan dhe e bënë më efektiv operacionin.

Ministri i Mbrojtjes tha se ndërhyrja në kohë dhe heroike e forcave tona shmangu më të keqen, ndërsa njoftoi se pak ditë më parë është realizuar për herë të parë një kontratë model për mirëmbajtjen e helikopterëve. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Bajram Begaj tha se Forcat e Armatosura janë përballur në një luftë të ashpër me zjarret për 3 javë, por ia kanë dalë që të minimizojnë dëmet dhe të shpëtojnë jetë njerëzish. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Emergjencës Civile Haki Çako deklaroi si rezultat e vatrave masive që përfshinë vendin gjatë periudhës korrik-gusht u dëmtuan 33,420 hektarë kullota, pyje e shkurre si dhe mbi 14.234 mijë rrënjë ullinj e pemëtari. Ndërsa në të gjithë vendin shpërthyen 389 vatra zjarri



“Medalje e Artë për Vlerësim Profesional” dhe “Medalje e Mirënjohjes”

Forca Tokësore dekorohet për kontributin e dhënë në menaxhimin e emergjencave në shuarjen e zjarreve

Pas një muaji sfidues të përballjes me zjarret që përfshinë vendin, më 03 shtator 2021 në Bazën Ajrore të Farkës u zhvillua ceremonia e vlerësimit të strukturave dhe individëve që u angazhuan në operacionet për shuarjen e zjarreve në vend. Pjesë e kësaj ceremonie ishte kryeministri Edi Rama, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj, ambasadori i Bashkimit Evropian Luigi Soreca, zëvendësambasadori i SHBA, si dhe zyrtarë të lartë të ftuar në vend.

Kjo ceremoni u zhvillua me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të të gjitha strukturave që kontribuan për shuarjen e zjarreve në vend, Forcave të Armatosura, Policisë së Shtetit, Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile etj.

Forca Tokësore u dekorua me “Medaljen e Artë për Vlerësim Profesional” nga kryeministri i Republikës së Shqipërisë, si dhe me “Medaljen e Mirënjohjes” nga ministri i Mbrojtjes, për kontributin e dhënë në shuarjen e zjarreve.

Gjithashtu, u nderuan me medalje komandantët e dy strukturave vartëse të FT, nënkolonel Gëzim Marku, komandant i Batalionit III të Këmbëorisë dhe major Pëllumb Hidri zëvendëskomandant i Batalionit Komando.

Në fjalën e tij, kryeministri Edi Rama ndër të tjera theksoi: “Medalje e artë për Forcën Tokësore dhe dua t’u them të gjithë trupave, është mesazh për të gjithë trupat e Emergjencave Civile, se do të bëjmë të pamundur për për të rritur pagat, që nuk do të jetë asnjëherë e mjaftueshme, sidoqoftë është një motiv më shumë jo vetëm për të çuar në shtëpi të ardhura të merituar nga puna, por edhe për të ndjerë vlerësimin dhe respektin për vendin dhe atdheun”.

Në fjalën e tij ministri i Mbrojtjes kërkoi sa më shumë reflektim nga organet vendore në përballimin e kësaj situatë. Ai u shpreh se duhet modernizim i legjisllacionit, planifikim logjistik, ngritje të kapaciteteve të reja për përballimin e çdo emergjence.

Ceremonia u përfundua me vendosjen e medaljes së artë në Flamurin Luftarak të Forcës Tokësore.



Përmbillet me sukses misioni i shuarjes se zjarreve në Shqipëri

Ministri Peleshi falënderon BE- në, Holandën dhe Çekinë për mbështetjen

Në përfundim të operacioneve për shuarjen e zjarreve në Shqipëri, ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi ka falënderuar Holandën për ndihmën e dhënë në këtë situatë të vështirë për vendin tonë.

Mbështetja e Mbretërisë së Holandës dhe Republikës Çeke nëpërmjet Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të BE ka rezultuar thelbësore në përballimin e situatës së zjarreve të krijuar në vendin tonë gjatë muajit gusht.

Në aktivitetin e organizuar në 27 gusht 2021, në pjesën ushtarake të Aeroportit Ndërkombëtar "Nënë Tereza", ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi falënderoi Ambasadorin e BE-së, Luigi Soreca, si dhe të gjithë ekipin holandez për ndihmë e dhënë dhe për mbylljen me sukses të këtyre operacioneve.

"Është momenti për të falënderuar së pari delegacionin Evropian, Ambasadorin personalisht, sepse përmes organizmave të BE kemi bërë të mundur që në një kohë shumë të shpejt të sigurojmë një mbështetje solidare nga dy shtete anëtare të BE, shtete mike si Holanda dhe Çekia, ndaj unë dua ta falënderoj edhe ambasadorin e Holandës dhe përfaqësuesit e ambasadës së Çekisë. Jemi thellësisht të prekur për solidaritetin e treguar në momentin kritik të kësaj stine shume të nxehtë e të jashtëzakonshme. U bëmë të gjithë bashkë institucionet në nivel vendor dhe qendror, por edhe vendet partnere mike për ta përballuar me sukses.", tha Peleshi.

Ambasadori i Bashkimit Evropian në Shqipëri, Luigi Soreca i pranishëm në aktivitet falënderoi ekipet holandeze dhe çeke për ndihmën,

për kontributin mjaft pozitiv që kanë dhënë për të mbrojtur mjedisin e shpëtuar jetë. Po ashtu ai falënderoi shtetin shqiptar për solidaritetin që tregoi me pritjen e 120 trupave të parë afganë që mbërritën në Shqipëri.

"Kjo është ajo që ne quajmë

skuadra e Evropës dhe është ajo që bën të gjitha përpjekjet për të ndihmuar të gjithë partnerët e ngushtë. Me sa kuptuam edhe nga ministri i Mbrojtjes ndihma e dhënë nga këto ekipe ka qenë thelbësore, në këtë verë të vështirë me zjarre në pyje. BE dhe shtetet evropiane edhe



njëherë kanë dëshmuar solidaritetin e tyre me Shqipërinë. Tani jemi në Aeroportin e Rinasit, ku pak orë më parë kanë zbritur 120 refugjatët e parë afganë, do të doja gjithashtu të përshëndesja Shqipërinë për solidaritetin e treguar.”, tha Soreca

I pranishëm në këtë aktivitet Ambasadori holandez në Shqipëri, Reinout Vos, falënderoi Bashkimin Evropian për vendimin e shpejtë që morën për të ndërhyrë si dhe trupat shqiptare për punën e tyre në luftën me zjarret dhe bashkëpunimin shumë të mirë.

Helikopterët holandezë dhe ai çek, që prej datës 6 gusht iu bashkuan përpjekjeve të Forcave të Armatosura dhe autoriteteve të tjera lokale për përballimin e situatës së krijuar nga zjarret.



Certifikatë Mirënjohjeje për shuarjen e zjarreve

Gjeneralmajor, prof.asoc Begaj vlerëson ushtarakët holandezë që morën pjesë në operacionin

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FARSH, gjeneralmajor prof.asoc Bajram Begaj, (30 gusht 2021), u ka akorduar “Certifikatë Mirënjohje” ushtarakëve holandez, të cilët në kuadër të mekanizmit Evropian të Mbrojtjes Civile morën pjesë në operacionin e ndërhyrjes nga ajri për shuarjen e zjarreve në vendin tonë, me motivacionin: “Për profesionalizmin, bashkëpunimin dhe sakrificën tuaj për të mbështetur Forcat e Armatosura Shqiptare gjatë operacioneve të shuarjes së zjarrit në Shqipëri. Miqësia e vërtetë është krijuar gjatë kohëve të vështira, kështu që ne vlerësojmë partneritetin që lidh kombet tona përmes organizatave euro-atlantike”.

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast, e cila u zhvillua në ambientet e garnizonit Rinas, në emër të SHSHPFA, trupat e ushtrisë holandeze u përshëndetën dhe u falënderuan për punën e shkëlqyer që bënë në përmbyllje të operacionit të ndërhyrjeve

nga ajri me helikopterët Chinook për shuarjen e zjarreve nga shefi i operacioneve të Komandës së Forcës Ajrore, kolonel Genci Petani i cili u dorëzoi dhe certifikatat e mirënjohjes të akorduara nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor, prof.asoc Bajram Begaj.

Nga ana e tij, drejtuesi i operacionit i Ushtrisë Holandeze, major Ernst van Lankveld, falënderoi shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA për vlerësimin e bërë, Forcat Ajrore Shqiptare për mbështetjen e bashkëpunimin e shkëlqyer që patën në përmbylljen me sukses të këtij operacioni si dhe në shenjë kujtimi dhuroi një foto nga operacioni i tyre për shuarjen e zjarreve me helikopterin Chinook në Shqipëri.

Më herët, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor prof.asoc. Bajram Begaj zhvilloi një bisedë telefonike me shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA së Mbretësisë së Hollandës, gjeneral Onno Eichelsheim, të cilin e falënderoi për gatishmërinë e treguar dhe mbështetjen me kapacitete ajrore për operacionet e fikjes së zjarrit në territorin e RSH. Gjithashtu, në shenjë mirënjohjeje për mbështetjen e treguar, gjeneralmajor Begaj i dërgoi një letër falenderimi gjeneral Eichelsheim, me anë të së cilës nënvizoi performancën, përkushtimin dhe bashkëpunimin e personelit pilot holandez të angazhuar në operacion. “Ndërhyrja e njëjve ajrore të Hollandës ishte një faktor përcaktues në suksesin e misionit...” - u shpreh ndër të tjera në letrën e falenderimit, gjeneralmajor Begaj.





Zjarret në vend, Ambasadorja Kim në Pashaliman

SHBA në krah të Shqipërisë

Situata problematike e zjarreve për shkak të temperaturave të larta që kanë përfshirë vendin tonë, ka bërë që ambasadorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë, Yuri Kim të zbresë në Pashaliman, Vlorë.

Ambasadorja e SHBA-së në Shqipëri, Yuri Kim në datën 10 gusht 2021, së bashku me ekspertë nga USAID dhe përfaqësues të lartë nga Ambasada e SHBA-së në Tiranë, zhvilluan një takim në Pashaliman, me ministrin e Mbrojtjes, Niko Peleshi, drejtorin e Përgjithshëm të AKMC, Haki Çako dhe titullarë të tjerë të lartë nga strukturat vendore.

Në një njoftim për mediet, Ambasada Amerikane në Tiranë theksoi se ambasadorja Kim, në emër të popullit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, shprehu trishtimin e thellë për dëmin e shkaktuar nga zjarret në Shqipëri. QQ

“Mendimet tona shkojnë për të gjithë shqiptarët gjatë kësaj kohe të vështirë, veçanërisht me ata jetët e të cilëve janë prekur nga shkatërrimi. Ne i jemi mirënjohës personelit ushtarak dhe zjarrfikësve për aktet e tyre heroike për të luftuar zjarret

Çastet kur miqtë dhe aleatët qëndrojnë së bashku

dhe ndihmuar në parandalimin e humbjeve të mëtejshme të jetëve dhe pronës. Gjithashtu do të doja të falënderoja Ministrin e Mbrojtjes Peleshi, Shefin e Shtabit Begaj dhe Drejtorin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile Çako për përpjekjet e tyre në udhëheqjen e përgjigjes ndaj këtyre zjarreve”, tha ambasadorja Kim.

“Unë sot jam në rajonin e Vlorës për të takuar ekipin tonë amerikan të ekspertëve nga Byroja për Ndhimë Humanitare e USAID, të cilët erdhën në Shqipëri për të ndihmuar me përpjekjet e koordinimit dhe përgjigjes. Unë jam mirënjohëse për përgjigjen e tyre të shpejtë ndaj thirrjes për ndihmë. Ata tashmë kanë filluar të trajtojnë sfidat, duke punuar së bashku me partnerët tanë shqiptarë. Këto përpjekje të përbashkëta dhe bashkëpunimi midis vendeve tona është ajo çka aleatët bëjnë për njëri -tjetrin në kohë nevojë. Këto janë çastet kur miqtë dhe aleatët qëndrojnë së bashku për të përballuar këto sfida të vështira”, vijoi Kim.

“Unë jam gjithashtu shumë e kënaqur që planifikimi i mëparshëm i emergjencës midis vendeve tona

po ndihmon me këto përpjekje, veçanërisht dhurimet e pajisjeve të zjarrfikësve nga Komanda Evropiane e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në 2019. Pajisjet e zjarrfikësve, të tilla si kovat “Bambi” të përdorura nga helikopterët, tani po përdoren për të shpëtuar jetë”, tha ajo. “Më lejoni ta them sërish, populli amerikan është në krahun tuaj – dhe do të jetë gjithmonë në krahun tuaj – gjatë kohëve të vështira”, përfundoi ambasadorja Kim. “SHBA është në krah të Shqipërisë edhe në këtë situatë të vështirë me zjarret, që ka prekur vende të ndryshme të botës”, tha ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi. “Prita sot, në bazën e Pashalimanit ambasadorin Yuri Kim, me të cilën ndamë shqetësimin për gjendjen. E falenderova ambasadorin për ndihmën që SHBA ka dhënë në pajisje dhe jo vetëm, për emergjencat civile. Mirënjohje për kontributin e ekipit amerikan të ekspertëve nga Byroja për Ndhimë Humanitare e USAID, të cilët kanë ardhur në Shqipëri për të ndihmuar me përpjekjet e koordinimit dhe përgjigjes ndaj flakëve.”, shkroi ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi.

Ministri Peleshi: Situatë më e qetë zjarresh në vend, u shuan 175 vatra

Pas dy javësh në betejë me zjarret në të gjithë territorin e Shqipërisë, situata në datën 11 gusht 2021, paraqitet më e qetë. Në të gjithë vendin janë shuar 175 zjarre, ndërsa mbeten aktive 9 vatra. Në këto operacione janë angazhuar rreth 3.000 efektivë të Forcave të Armatosura, rreth 150 mjete të FA, rreth 300 forca policore, rreth 1800 forca zjarrfikëse, mbi 370 mjete të MZSH, 20 ambulanca, mbi 1.000 punonjës bashkiakë, mbi 300 punonjës të shërbimit pyjor, 101 punonjës të Agjencisë së Zonave të Mbrojtura dhe 822 forca vullnetare.

Ndërhyrja nga ajri u krye përmes ekuipazheve të 7 helikopterëve të Shqipërisë, Holandës dhe Çekisë. Një ndihmë e madhe në punën për shuarjen e zjarreve ishte edhe mbështetja me pajisje nga SHBA.

Aktualisht nuk ka më vatra zjarri në gadishullin e Karaburunit, por puna po vijon në Dukat të Ri, nga toka dhe nga ajri për të normalizuar tërësisht situatën për të shmangur çdo mundësi riaktivizimi. Më e qetë paraqitet situata edhe në Mirditë, ku po vijon puna për stabilizimin e flakëve në fshatin Thirrë. Nën kontroll po mbahen vatrat në fshatin Munellë dhe Domgjon. Po vijon puna nga toka dhe nga ajri për të izoluar vatrat e zjarrit në Majën e Rrunës, njësi administrative Malzi. Situata nuk paraqet më rrezik për tunelin e Kalimashit. Nën monitorim janë disa vatra zjarri në vendin e quajtur Dragodi, në luginën e Valbonës në Tropojë, ku dyshohet zjarvënie e qëllimshme. Janë izoluar vatrat në drejtim të fshatit Patalej në Lezhë. Vijon puna për normalizimin e vatrës së riaktivizimit në zonën e mbrojtur të Guri i Nikës në Pogradec, ku nuk paraqitet rrezik për banesa. Janë drejt

“Ndërhyrja nga ajri u krye përmes ekuipazheve të 7 helikopterëve të Shqipërisë, Holandës dhe Çekisë. Një ndihmë e madhe në punën për shuarjen e zjarreve ishte edhe mbështetja me pajisje nga SHBA



shuarjes përfundimtare vatrat e zjarrit në Malin e Tomorrit dhe në fshatin Therpel në Skrapar. “Më në fund pas 2 javësh mundi dhe sakrificash, nuk ka më vatra zjarri në Karaburun. Qindra orë betejash, qindra trupa të Forcave të Armatosura e forcave zjarrfikëse, specialistë të zonave të mbrojtura dhe emergjencave civile kanë punuar pa u lodhur për të shpëtuar Parkun Kombëtar të Llogarasë.”, tha ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi. “Kjo stinë e nxehtë s’ka mbaruar por sot, në këtë moment frymëmarrjeje dua t’i falenderoj të gjithë ata që dhanë gjithçka në këto ditë të vështira. Të gjithë po bëjmë detyrën por disa heronj shkojnë

përtej detyrës. Prefekti Flamur Mamaj, komandantët që drejtuan operacionet e vështira Gëzimi, Pëllumbi, Idrizi, Arbeni, punonjësit e Agjencisë së Mbrojtjes Civile, punëtorët e palodhur të zonave të mbrojtura si Nexhipi, Ganiu e të tjerët që nuk i takova dot sepse ishin gjithë kohën në frontin e betejës me zjarret, pilotët Juliani, Agimi, Ervini dhe Agroni, janë shqiptarë të rrallë që meritojnë respekt dhe mirënjohje. Nuk mund ta le mënjani çdo ushtar të thjeshtë që nuk ia mësova dot emrin por i pashë veprën. Sfida vazhdon. Ne jemi të gatshëm në krah të komuniteteve lokale.”, tha ministri i Mbrojtjes Peleshi.



KONGRESMENI AMERIKAN MIKE QUIGLEY

Ministri Peleshi: Angazhimi i Shqipërisë përkrah SHBA dhe aleancës së NATO është i padiskutueshëm

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, priti në takim kongresmenin amerikan Mike Quigley në 19 gusht 2021. Kongresmenin Quigley shoqërohej

nga ambasadorja amerikane në Shqipëri znj. Yuri Kim. Në takim me ministrin e Mbrojtjes Niko Peleshi të pranishmit diskutuan rreth marrëdhënieve të shkëlqyera mes Shqipërisë dhe SHBA, si dhe marrëdhënieve në fushën

e sigurisë dhe mbrojtjes. “Nga takimi me kongresmenin amerikan Mike Quigley, me të cilin diskutuam për marrëdhëniet e shkëlqyera mes Shqipërisë dhe SHBA, sidomos në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.”, informoi



Baza e Kuçovës do të marrë një financim prej 58 milionë dollarësh nga NATO, për t'a modernizuar atë tërësisht, në mbështetje të transportit ajror, logjistikës, politikave ajrore dhe trajnimeve të NATO-s



ministri Peleshi "Angazhimi i Shqipërisë përkrah SHBA dhe aleancës së NATO është i padiskutueshëm", shkroi ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi në profilin e tij zyrtar në rrjetin social, teksa publikoi fotot nga takimi.

Kongresmeni Mike Quigley përfaqëson distriktin e 5-të të Illinois. Gjatë vizitës së tij në Tiranë në datat 18 dhe 19 gusht ai u takua me ambasadoren Kim, ministrin e Mbrojtjes Niko Peleshi, shefin e Shtabit, gjeneralmajor Ba-

jram Begaj dhe vizitoi bazën ajrore të Kuçovës. Baza e Kuçovës për modernizimin e saj do të marrë një financim prej 58 milionë dollarësh nga NATO. Ky financim ka parasysh modernizimin tërësisht të bazës, në mbështetje të transportit ajror, logjistikës, politikave ajrore dhe trajnimeve të NATO-s.

Ndërkohë Ambasada e SHBA-së në Tiranë publikoi fotot nga takimi i ambasadores, Yuri Kim, e cila mirëpriti kongresmenin e Shteteve të Bashkuara Mike Quigley në datat 18 dhe 19 gusht. "Ambasadorja Kim mirëpriti Kongresmenin e Shteteve të Bashkuara Mike Quigley në Shqipëri këtë javë. Kongresmeni përfaqëson distriktin e 5-të të Illinois dhe në datat 18 dhe 19 gusht ishte në Tiranë, ku u takua me Ambasadoren Kim, Ministrin e Mbrojtjes Niko Peleshi, Shefin e Shtabit Begaj dhe vizitoi bazën ajrore të Kuçovës. Baza e Kuçovës do të marrë një financim prej 58 milionë dollarësh nga NATO, për t'a modernizuar atë tërësisht, në mbështetje të transportit ajror, logjistikës, politikave ajrore dhe trajnimeve të NATO-s.", tha ambasada Amerikane në Tiranë.

Baza Ajrore e NATO-s në Kuçovë

Bashkëpunimi është alternativë që garanton suksese

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral-major Begaj, pret Kongresmenin Quigley. Kongresmeni Quigley u njoh nga afër me projektin e transformimit të bazës Ajrore të Kuçovës në një bazë taktike të NATO-s.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral-major prof. asoc. Bajram Begaj, priti në një vizitë njohëse në bazën Ajrore të Kuçovës, Kongresmenin e SHBA, z. Michael Quigley, të shoqëruar nga stafi i tij dhe pjesëtarë civilë dhe ushtarakë të Ambasadës së SHBA-së në Shqipëri.

Kongresmeni Quigley u njoh nga afër me projektin e transformimit të bazës Ajrore të Kuçovës në një bazë taktike të NATO-s. Gjatë vizitës në bazë, Z. Quigley vlerësoi rolin dhe angazhimet e FARSH për paqen dhe sigurinë në rajon dhe më gjerë në kuadër të Aleancës.

Gjeneralmajor Begaj nga ana e tij vlerësoi bashkëpunimin midis dy vendeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, duke veçuar asistencën e vyer

të SHBA në modernizimin e FARSH e së fundmi, në implementimin e projektit të bazës ajrore. "Baza Ajrore e Kuçovës u identifikua si një pikë strategjike për Aleancën edhe gjatë kryerjes së stërvitjes Defender-21, në të cilën SHBA shprehën mbështetjen për sigurinë e Ballkanit dhe Evropës në tërësi", u shpreh ndër të tjera gjeneral Begaj.

Kongresmeni Quigley është anëtar i disa komiteteve të Kongresit të SHBA-së, ku mund të veçohet Komiteti i Përvetësimeve dhe Komiteti i Përhershëm i Zgjedhur i Dhomës për Inteligjencën. Më herët, gjatë vizitës në Tiranë, Kongresmeni Quigley zhvilloi takim edhe me Ministrin e Mbrojtjes, Z. Niko Peleshi ku u vlerësua partneriteti strategjik midis dy vendeve e në veçanti në fushën e mbrojtjes.



Transformimi i bazës Ajrore të Kuçovës në bazë taktike të NATO-s

Baza Ajrore e Kuçovës, si një aset i Forcave tona të Armatosura sot është pranë ringritjes dhe në rrugën e shndërrimit të saj në një bazë të NATO-s.

Ajo është gjithashtu baza e vetme e Aleancës në Ballkanin Perëndimor. NATO do të shpenzojë mbi 50 milionë euro në fazën e parë të punës për ta kthyer Kuçovën në një bazë mbështetëse për furnizime, logjistikë, trajnim dhe manovra.

Baza Ajrore e Kuçovës ka një histori të vjetër për Forcat Ajrore shqiptare. Ajo ka filluar të përdoret si fushë aviacioni gjatë LIIB nga ushtria italiane dhe pas luftës nuk ka pasur aktivitet, deri në 5 maj të vitit 1955, datë e cila shënon inaugurimin, si baza e parë ajrore e Aviacionit Luftarak Shqiptar. Për 50 vjet ka qenë shkolla praktike e fluturimeve luftarake për të gjithë pilotët, teknikët, specialistët dhe inxhinierët e avionëve aktivë të diplomuar nga shkolla e aviacionit. Janë kryer mijëra orë fluturime ditën dhe natën.

Regjimenti u krijua si formacion i parë i madh luftarak i Forcave Ajrore, për mbrojtjen e hapësirës ajrore të Republikës së Shqipërisë. Bërthama e parë u krijua me vendim të posaçëm, ku u morën masa për përgatitjen e efektivit pilot e teknik për teknikën e re reaktive me të cilën do të pajisej reparti. Krahas këtyre u morën masa për përgatitjen e ambienteve për pritjen e efektivit dhe teknikës. Pas përfundimit të përgatitjes së efektivit pilot e inxhiniero-teknik, Regjimenti mori formën e plotë, i gatshëm për kryerjen e detyrave. Në janar të vitit 1956 filloi përgatitja luftarake e organizuar mbi bazën e një planëzimi të rregullt. Në maj të këtij viti u krijua nënreparti i oficinës së mirëmbajtjes së aviacionit. Në korrik



të vitit 1957 në këtë aerodrom u ul për herë të parë avioni bombardues JI- 28, i cili hyri në armatimin e Aviacionit tonë Luftarak. Në dhjetor në Kuçovë ulet një avion transporti anglez Skymaster. Në muajin prill të vitit 1961, për herë të parë filloi eksperimentimi i karburantit të markës shqiptare i prodhuar nga punonjësit e laboratorit të naftës. Në vitin 1964 në vartësi të regjimentit u krijuan dy reparte të reja, Batalioni i Shërbimit të Aerodromit dhe Grupi i Radio-Dritës. Në vitin 1965 krijohet skuadrilja e tretë reaktivo-mësimore për përgatitjen e pilotëve, teknikëve të rinj. Në fillim të vitit 1966 filluan punimet për ndërtimin e Uzinës së Riparimit të Avionëve, ndërsa në muajin prill reparti pajiset me një skuadrilje MIG-17. Në gusht të vitit 1975 eksperimentohet për herë të parë qitje natën me raketa, ndërsa në vitin 1977 për herë të parë eksperimentohet bombardimi nga fluturimi horizontal në lartësi të vogël.

Në vitin 1979, u vu në gatishmëri për drejtimin luftarak të regjimentit Vendkomanda e Kohës së Luftës. Në paradën ajrore me rastin e 35-vje-

torit të çlirimit të Atdheut, reparti mori pjesë me 9 avionë. Në vitin 1984 reparti emërohet "Regjimenti 23 i Aviacionit Gjuajtës Bombardues", ndërsa në vitin 1985 dekorohet me urdhërin "Për shërbime të shquara në fushën e mbrojtjes".

Në vitin 1995 krijohet Baza e Mbrojtjes Ajrore Kuçovë, viti 1999, është viti i kthimit në normalitet, ndërsa në vitin 2001, në strukturën e re organizative të Forcave Ajrore, ky repart kalon në Akademia e Forcave Ajrore, duke pasur në vartësi dhe Fakultetin Teoriko-Mësimor Vlorë. Në vitin 2003 vazhduan punimet nga pala turke në aerodromin e Kuçovës, të cilat përfunduan në kohë sipas planit. Në vitet në vazhdim si detyrë kryesore ka qenë modernizimi i infrastrukturës për plotësimin e standardeve dhe kushteve të aerodromit të Kuçovës si Host Nation Support. Baza e Kuçovës e ka kryer me sukses detyrën, sot në bazë zhvillohen fluturime bashkë me partnerët e NATO. Vendimi i Aleancës për ta kthyer në bazë taktike, shërben për të rritur shkallën e ndërveprueshmërisë me Aleancën.

Shqipëria përmbyll zyrtarisht kryesimin e Sekretariatit të SEDM-it, pas një drejtimi të suksesshëm

Bici: Shqipëria do të vazhdojë me të njëjtin ritëm të mbështesë SEDM

“Vendi ynë ka arritur shumë gjatë këtyre dy viteve duke punuar së bashku me të gjithë partnerët tanë. Ajo nënvizoi se Shqipëria do të vazhdojë me po të njëjtin ritëm të mbështesë këtë iniciativë të rëndësishme rajonale”.

Shqipëria ka përmbyllur zyrtarisht kryesimin e Sekretariatit të Iniciativës së Ministrave të Mbrojtjes të Evropës Juglindore (South-Eastern Europe Defence Ministerial - SEDM), pas një periudhe të suksesshme që mbajti kryesimin nga viti 2019 deri në 2021.

Më datë 26 gusht 2021, anëtarët e Sekretariatit të SEDM-it morën pjesë në ceremoninë për dorëzimit të Sekretariatit të SEDM-it dhe pasimit të stafetës palës bullgare, në qytetin e Kumanovës në Maqedoninë e Veriut, vendi ku është dislokuar brigada e SEEBRIG.

Delegacioni i Sekretariatit të SEDM-it kryesohej nga zëvendësministri i Mbrojtjes, Dallëndyshe Bici. Gjatë fjalës së vet, zëvendësministri Bici shprehu kënaqësinë e vendit tonë në përmbylljen e suksesshme të një pune dyvjeçare. Ajo theksoi vendosmërinë dhe përkushtimin e Shqipërisë gjatë kryesimit të Sekretariatit të SEDM-it për të vazhduar promovimin e rëndësishë të iniciativës së SEDM-it,

e cila është provuar të jetë një mekanizëm i suksesshëm i ndërtimit të sigurisë në Evropën Juglindore. Zëvendësministri Bici u shpreh se vendi ynë ka arritur shumë gjatë këtyre dy viteve duke punuar së bashku me të gjithë partnerët tanë. Ajo nënvizoi se Shqipëria do të vazhdojë me po të njëjtin ritëm të mbështesë këtë iniciativë të rëndësishme rajonale. Në përmbylljen e fjalës së saj, zëvendësministri i Mbrojtjes shprehu vlerësimin për komandantin e SEEBRIG, gjeneral brigade Aristeidis Iliopoulos dhe stafin e tij për punën dhe përpjekjet e vazhdueshme për të arritur sukses për të gjitha aktivitetet e SEEBRIG. Gjithashtu ajo shprehu urimet më të mira Sekretariatit të ardhshëm SEDM të kryesuar nga Bullgaria dhe i siguroi mbështetjen e vendit tonë gjatë rrugëtimit të tyre. Gjatë ceremonisë të dorëzimit të Sekretariatit të SEDM-it, anëtarët shqiptarë u vlerësuan me medalje nga kryetari bullgar i Sekretariatit të SEDM-it, për kontributin dhe punën e tyre dyvjeçare në këtë iniciativë.



Southeastern European Defense Ministerial (SEDM) vazhdon të jetë prova e gjallë e urave të konsoliduara të bashkëpunimit dhe të miqësisë, të cilën kemi qenë të aftë ta ndërtojmë nëpërmjet përforsimit të dëshirës së mirë dhe vizionit të përbashkët.

SEDM ose ndryshe procesi i angazhimit të vendeve të Europës Juglindore në nivel Ministerial, paraqet një proces të integritit dhe të bashkëpunimit në fushat e sigurisë dhe të mbrojtjes rajonale. I themeluar në vitin 1996 në Tiranë, me pjesmarrjen e gjithë vendeve të Europës Juglindore dhe SHBA, SEDM sot shpreh realisht suksesin e bashkëpunimit dhe integritit rajonal.

Në këtë proces marrin pjesë anëtarë si: Shqipëria, Bosnja-Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Greqia, Italia, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi, Rumania, Sllovenia, Serbia, Turqia, Ukraina dhe SHBA. Me statusin e vëzhguesit janë Moldavia dhe Gjeorgjia.

Vendet Anëtare: Shqipëri, Bosnje-Hercegovinë, Bullgari, Greqi, Itali, Kroaci, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi, Rumani, Turqi, Slloveni, Serbi, Ukraina, SHBA

Vendet Vëzhguese: Gjeorgji, Moldavi

SEDM është një iniciativë që përfshin: Iniciativën e Multinational Peace Force of South Eastern Europe (MPFSEE) ose Brigada e Europës Juglindore (SEEBRIG) dhe një numër projektesh. Midis tyre përmendim: SEESIM, CBSC, SEMEC, SEEDIRET, IMIHO si dhe projekte të tjera që po ndërmerren në kuadër

Roli, dinamika, angazhimi dhe shtrirja e tij në Europën Juglindore



të SEDM. Pjesë e këtij procesi janë edhe një numër i konsiderueshëm takimesh të të gjitha niveleve.

Sfondi historik i krijimit të Procesit të SEDM: Në shtator të vitit 1996, disa ministra të Mbrojtjes të rajonit si dhe Sekretari amerikan i Mbrojtjes u mbledhën në Tiranë, për të gjykuar e vendosur, se për ndërtimin e një të ardhme më të mirë për të gjithë rajonin ishte e domosdoshme gjetja e mënyrave efektive të komunikimit dhe krijimit e një klime bashkëpunimi e mirëkuptimi, veçanërisht në një rajon të ndarë për dhjetëvjeçarë të tërë nga mendësitë e të shkuarës, të për-

çarjes e të armiqësive. Ky moment dhe kjo filozofi përbën dhe zanafillën e procesit të Ministerialit të Europës Juglindore. Që nga ajo kohë e në vazhdim, SEDM ka qenë një mjet i frytshëm i zhvillimit dhe forcimit të bashkëpunimit rajonal, por edhe i forcimit të frymës së përgjegjësisë rajonale në fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë. Faktet e deritanishme të këtij procesi janë një dëshmi që flasin për vullnet të përbashkët dhe vendosmëri për të ecur në rrugën e bashkëpunimit në të mirë të paqes dhe stabilitetit rajonal, por edhe për të kontribuar përkrah bashkësisë ndërkombëtare në mbrojtje të lirisë,



paqes dhe demokracisë.

Historiku i përgjithshëm i këtij procesi është pasuruar vit pas viti, sikundër vetë procesi është rritur dhe ka zgjeruar, jo vetëm numrin e aktiviteteve, projekteve dhe angazhimeve, por edhe numrin e vendeve pjesëmarrëse dhe zgjerimin e kufijve të tij, aq sa emërtimi: “Ministeriali i Mbrojtjes i Europës Juglindore” nuk arrin të përmbledhë gjithë hapësirën gjeografike që mbulon ky proces. Ukraina, u bë anëtare me të drejta të plota në proces, në dhjetor 2005 gjatë takimit të ministrave të Mbrojtjes në Uashington D.C.

Në takimin e ministrave në Tiranë, në shtator 2006, Bosnja-Hercegovina, Gjeorgjia, Mali i Zi dhe Serbia, u shtuan si vende vëzhguese, ndërsa në tetor 2007 Bosnja-Hercegovina bëhet anëtare me të drejta të plota. Në takimin e ministrave në Tiranë, tetor 2010, Mali i Zi dhe Serbia bëhen anëtare me të drejta të plota të SEDM.

SEDM, në këtë kuadër ndjek “Politikën e dyerve të hapuara” për të gjitha vendet që demostrojnë dhe ndajnë vlera të përbashkëta në drejtim të sigurisë, paqes dhe stabilitetit në rajon e më gjerë.

Me të drejtë, me këtë zgjerim, SEDM vetëshfaqet si një proces mjaft i sukseshëm, që jo vetëm ka përmbushur objektivat fillestare të rritjes së bashkëpunimit dhe sigurisë në rajonin e Europës Juglindore, por madje i ka tejkaluar ato, duke zgjeruar ndikimin e tij përtej vendeve të rajonit tonë. Ka trembëd-

hjetë vjet që SEDM bashkon vendet e rajonit në një sërë aktiviteteve, të materializuara në projekte të përbashkëta dhe angazhime në fushën e armë-kontrollit, sigurisë së kufijve, luftës kundër terrorizmit, demilitarizimit, shkëmbimit të teknologjisë ushtarake, stërvitje të përbashkëta, operacioneve për parandalimin e fatkeqësive natyrore, e deri në ndërmarrjen e misioneve paqeruajtëse jashtë rajonit.

Gjatë kësaj periudhe, procesi i SEDM ka dëshmuar se bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes ka qenë mjaft i frytshëm në gjenerimin e një fryme mirëbesimi dhe respekti reciprok. Vendet anëtare e shohin njëri-tjetrin në dritën e miqësisë dhe partneritetit, larg mosbesimit dhe frymës kundërshtuese. Nga ana tjetër, përveç qëllimit të forcimit të lidhjeve të bashkëpunimit dhe bashkëpunimit ndërmjet vendeve të SEDM, ky proces ka luajtur edhe një rol të madh në afrimin e vendeve joanëtare të strukturave Euroatlantike tek këto struktura, duke u dhënë këtyre vendeve mundësinë të bashkëpunojnë suksesshëm me vendet e tjera anëtare të NATO ose BE, anëtare të SEDM dhe duke u ofruar shansin të shprehin e demonstrojnë vullnetin e tyre për të qenë pjesëtarë të denjë të familjes Euroatlantike.

Ngritja e Forcës Shumëkombëshe Paqeruajtëse të Europës Juglindore (MPFSEE) (SEEBRIG), është arritja më e dukshme ndërmjet një numri nismash në sektorë të trajnimit dhe organizimit, është

një arritje e shkëlqyer e procesit të integritit e cila ka qenë një objektiv i vazhdueshëm për të gjitha vendet, përgjatë këtyre viteve. SEDM ka qenë i suksesshëm në ngritjen e një historie të përbashkët efektive ushtarake, e aftë të operojë në hapësirat e territorit rajonal, por edhe të ndërmarrë misione për paqen dhe stabilitetin jashtë këtij territori.

Dislokimi dhe përfundimi i misionit të SEEBRIG në Afganistan, shkurt - gusht 2006, në kuadër të ISAF, paraqet pa diskutim edhe suksesin më të madh të kësaj force, arritur në sajë të frymës së madhe dhe të kurdohershme të bashkëpunimit, që ka gjeneruar e demonstruar SEDM gjatë historisë së tij të re.

Shqipëria mori kryesimin e Sekretariatit të Komitetit Koordinues të Ministerialit të SEDM (SEDM-CC) dhe Komitetit Drejtues Politik-Usharak të Forcës Shumëkombëshe Paqeruajtëse (PMSC/MPFSEE) në korrik 2005 - korrik 2007.

Funksionimi i procesit të SEDM

Baza e funksionimit të këtij procesi janë negociimi dhe konsensusi.

Nëpërmjet Sekretariatit të SEDM që luan rolin e moderatorit dhe katalizatorit, forumet e këtij procesi zhvillojnë një proces aktiv negociimesh. Këto negociime përfshijnë dy momente kryesore: takime informale (takime, korrespondenca, konsulta) dhe takime formale institucionale. Takimet formale janë të institucionalizuara në takime

të komiteteve politike (PMSC dhe SEDM-CC) dy herë në vit; në takime në nivel zëvendësshef/shefa shtabeve një herë në vit dhe në takime të ministrave të Mbrojtjes një herë në vit. Gjithashtu zhvillohen takime të rregullta të eksperteve, takime të Grupeve të Punës si dhe takime të jashtëzakonshme. Takimet thirren dhe menaxhohen nga Sekretariati i SEDM dhe mund të kërkohen nga vendet anëtare, apo nga forumet e SEDM.

Kryesimi i procesit të SEDM është me rotacion dyvjeçar ndër-mjet vendeve anëtare të PMSC, historiku i marrjes së kryesimit ka qenë si më poshtë:

1999 - 2001 Greqia
2001 - 2003 Rumania
2003 - 2005 Turqia
2005 - 2007 Shqipëri
2007 - 2009 Maqedoni
2009 - 2011 Bullgari
2011 - 2013 Italia
2013 - 2015 Rumani
2015 - 2017 Turqi
2017 - 2019 Greqi
2019 - 2021 Shqipëri
2021 - 2023 Bullgari

Objektivat e SEDM

Rritja e kontributit të SEDM-it dhe iniciativës së MPFSEE-së për Paqe dhe Stabilitet rajonal

Rritja e bashkëpunimit rajonal midis vendeve të SEDM-it në përbalimin e kërcënimeve të mundshme dhe luftës kundër terrorizmit

Përsheptimi i proceseve të integritetit të vendeve të SEDM joanëtare të NATO, në strukturat Euro-Atlantike

Rritja e kapaciteteve operationale të SEEBRIG për dislokim dhe pjesëmarrje në operationet e mbështetjes së paqes

Hartimi, vënia në zbatim dhe konsolidimi i projekteve të ndryshme, të cilat i shërbejnë rritjes së mëtejshme të kapaciteteve operationale dhe bashkëpunimit midis vendeve të SEDM-it që i vijnë në ndihmë paqes dhe sigurisë rajonale

Ndjekja e politikës së dyerve të hapura për vendet, që shprehin interes pjesëmarrjeje në procesin e SEDM dhe nismën e MPFSEE

Lidhja dhe forcimi i marrëdh-

ënive dhe bashkëpunimit me organizata e organizma të ndryshëm rajonalë e ndërkombëtarë, në fusha me interes të përbashkët, në mënyrë të veçantë me institucionet Euro - Atlantike

Struktura dhe takimet kryesore të procesit

Krijimi i SEDM-CC: Është për t'u theksuar se iniciativat dhe aktivitetet në kuadrin e SEDM u rritën dhe kërkohin një strukturë të përshtatshme në kuadrin e këtij procesi, për koordinimin e iniciativave dhe aktiviteteve në përgjithësi. Me anë të një marrëveshjeje e cila u nënshkrua në Selanik të Greqisë më 9 tetor 2000, vendet anëtare



të SEDM krijuan Komitetin Koordinues të Ministerialit të Mbrojtjes të Europës Juglindore (SEDM-CC). Vendet anëtare të SEDM-CC janë vendet anëtare dhe vëzhguese të PMSC.

Sekretariati i SEDM-CC & PMSC: Kryesimi i procesit të SEDM është me rotacion dyvjeçar. Vendi i cili mban kryesimin e radhës, drejton dhe Sekretariatit e SEDM-CC & PMSC. Vendet kryesuese kanë qenë: Greqia, Rumania (2001-2003), Turqia (2003-2005), Shqipëria (2005-2007), ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë (2007-2009), Bullgaria (2009-2011), Italia ka kryesimin e radhës (2011 - 2013). Detyra kryesore e Sekretariatit të SEDM është mundësimi i asistencës në

takimet e përmendura më lart, drejtimi, mbajtja e korrespondencës dhe arkivimi i takimeve të komiteteve të mësipërme.

Komiteti Drejtues Politiko-Usharak (PMSC): Komiteti Drejtues Politiko-Usharak (PMSC) i MPF-SEE, bën koordinimin, menaxhimin dhe dhënien e direktivave për të gjitha çështjet që lidhen me Forcën Paqeruajtëse Shumëkombëshe të Europës Juglindore, apo e njohur ndryshe Brigada e Europës Juglindore (SEEBRIG).

Delegacionet e vendeve anëtare: Delegacionet e vendeve anëtare të Sekretariatit të SEDM-CC dhe PMSC takohen rregullisht dy herë në vit, në vendin ku aktualisht drejtohet

sekretariati. Takimi i fundit i PMSC dhe SEDM-CC u organizua në Sofje, 13-15 shtator 2010. (Konkretisht takimi i 24 i PMSC dhe takimi i 23 i SEDM-CC).

Ministrat e Mbrojtjes dhe zëvendësshefat e Shtabit takohen çdo vit në takimin e nivelit të lartë.

Takimi i ministrave të Mbrojtjes në kuadër të SEDM është zhvilluar dy herë në vendin tonë.

SEDM ka qenë dhe është një iniciativë e orientuar mbi funksionimin e projekteve. Aktualisht në kuadër të SEDM zhvillohen projektet si: Interconnection of Military Hospitals Project (IMIHO)

- Building Integrity (BI); SEDM Portal; Female Leaders Security in Defense (FLSD); South East Europe Simulation Exercise (SESIM).




Ministri i Mbrojtjes i Kosovës vizitë në Tiranë

Peleshi: Investime të përbashkëta në fushën e Mbrojtjes

Shqipëria dhe Kosova do të forcojnë ndjeshëm bashkëpunimin në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. Lajmin e dhanë ministrat e vendeve të të shteteve gjatë vizitës zyrtare të ministrit të Mbrojtjes së Republikës së Kosovës Armend Mehaj në Tiranë, në 26 gusht 2021, ku u prit me nderime nga homologu i tij Niko Peleshi.

Fillimisht zoti Peleshi e falenderoi ministrin Mehaj për ndihmën e trupave të Forcës së Sigurisë së Kosovës në shuarjen e zjarreve gjatë këtij muaji në qarkun e Kukësit dhe më pas bëri publike ambiciet e dy shteteve për të rritur ndjeshëm bashkëpunimin mes forcave të armatosura. "Kemi biseduar edhe sot në vijim të bisedave dhe diskutimeve në vizitën zyrtare në maj të këtij viti, për një integrim sa më të madh dhe më intensiv në fushën e edukimit. Ne kemi një projekt dhe një ambicie për të ridimensionuar Akademinë tonë të Forcave të Armatosura, për ta ngritur atë në një nivel tjetër. Për t'ju përqasur modeleve më të mira po orientohemi kryesisht nga modeli i Ëest Point në SHBA. Fjala kyçe e gjithë takimit të sotëm ka qenë fjala komplemetare, apo smart defense. Si në fushën e edukimit ashtu edhe në fushën



e mirëmbajtjes së kapaciteteve tona, në fushën e inteligjencës, pa dyshim edhe në shumë fusha të tjera ka shumë vend për të kaluar në një qasje të re, në qasjen e komplementaritetit. Thënë ndryshe e bashkimit të forcave, e ekonomizimit të forcave në mënyrë që të shmangim bërjen e së njëjtës gjë, e të njëjtit investim pa qenë e nevojshme për t'u zhvilluar në dy shtetet tona. Madje edhe më gjerë se kaq, jo vetëm Shqipërisë dhe Kosovës, por edhe ndërmjet vendeve të tjera të rajonit." - u shpreh ministri Peleshi.

Nga ana e tij, ministri i Mbrojtjes i Republikës së Kosovës Armend Mehaj dha detaje të tjera sa i përket bashkëpunimit në fushën e arsimit ushtarak, si dhe konfirmoi bashkëpunimin për investimet e përbashkëta. "Kemi rënë dakord edhe me ministrin e Mbrojtjes që

të rrisim bashkëpunimin sa i përket edukimit. Kosova të këtë edukimin e shkollës së mesme ushtarake dhe atë të shkollës së lartë ushtarake ta ketë Shqipëria. Sinkronizimi i edukimit të jetë brenda trojeve tona. Ne folëm edhe për bashkëpunim më të ndërsjellë sa i përket pajisjeve ushtarake që në të ardhmen të mos jenë investime në të dyja anët ose në të gjithë rajonin njërin ta këtë Kosova, njërin ta ketë Shqipëria, tjetrin ta ketë Maqedonia ose Mali i Zi, që të jemi më të sinkronizuar dhe të bashkëpunojmë për t'i ardhur në ndihmë njëri - tjetrit nëse është nevoja ose nëse kërkohet mirëmbajtje." - theksoi ministri Mehaj.

Gjithashtu, dy ministrat u zotuan që vizitat e ndërsjella të niveleve të larta të ministrive të Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura të bëhen shumë më të shpeshta.

INTERVISTOI: HAJRIE DEDAJ

Mjeku është ai person që i kushton njohuritë dhe aftësitë e tij për parandalimin dhe trajtimin e sëmundjeve, ruajtjen dhe rritjen e shëndetit të njeriut. Mbetet një nga profesionet më të kërkuar dhe të vlerësuar nga shoqëria. Shpesh perceptohet si një profesion për altruistët, kjo pasi misioni është mbrojtja e shëndetit të shoqërisë, të njerëzve. Në vetëdijen kolektive, profesioni mjekësor është i lidhur kryesisht me shërbimin publik. Reputacioni i një mjeku përcaktohet nga profesionalizmi i tij, qëndrimi ndaj pacientit, angazhimi total, njohuritë e tij teorike dhe aftësitë praktike. Ky profesion nënkupton mendje të shëndetshme, kapacitet intelektual, trajnim të vazhdueshëm, zbatim të praktikave më të mira. Një mjek i mirë dallohet nga marrëdhënia me pacientët e tij, aftësitë dhe teknikat e tij psikologjike, sigurisht dhe cilësitë personale si mirësia, të qenit human, dhembshuria, ndjeshmëria dhe durimi. Vitet e fundit kufijtë e teknologjisë mjekësore janë zgjeruar drejt të paimagjinueshmes. Sidoqoftë, edhe me të gjitha këto risi teknologjike, pozicioni i mjekëve në shoqëri nuk është zvogëluar, mjekët mbeten të domosdoshëm.

Edhe në Forcat e Armatosura kjo domosdoshmëri nuk zbehet aspak, përkundrazi i shtohet edhe vlera dhe rëndësia që kanë shërbimet ushtarake për shoqërinë e një vendi.

Shërbimet mjekësore ushtarake janë një komponent i rëndësishëm i forcave të armatosura të një kombi, duke siguruar mbështetje mjekësore gjatë shërbimeve ushtarake, dhe gjithashtu duke u kujdesur për personelin ushtarak dhe përfituesit e tjerë në vendndodhjet e garnizoneve. Shërbimet mjekësore ushtarake përfaqësojnë një shtyllë kryesore të shërbimeve shëndetësore të financuara nga qeveria dhe që japin një kontribut të rëndësishëm në reagimin kombëtar ndaj fatkeqësive.

Ndër të rinjtë e të rejtat shqiptare që studiojnë jashtë vendit në akademitë më të mira ushtarake apo në fushën e mjekësisë ushtarake, janë edhe nëntoger Dajana Zenelaj dhe nëntoger Hygerta Illica, të cilat sapo kanë përfunduar studimet për mjekësi ushtarake në "Gulhane Askeri Tip Akademisi", në Ankara të Turqisë.

Për të ditur më shumë rreth eksperiencës së tyre të studimeve, realizuam një intervistë ku ato ndanë me ne rrugëtimin, eksperiencën dhe sfidat e tyre. Dy vajza të reja të forta

Sfidat, vështirësitë, përgjegjësitë dhe triumfi i ëndrrës



Nëntoger Dajana Zenelaj dhe nëntoger Hygerta Illica, të cilat sapo kanë përfunduar studimet në "Gulhane Askeri Tip Akademisi"



dhe plot vullnet për të punuar, për të dhënë dhe ato kontributin e tyre në fushën e mjekësisë ushtarake për të cilën kanë studiuar plot 7 vite. Fillimisht vitin e parë kanë mësuar gjuhën turke, 6 vitet e tjera iu dhanë skalitjes së profesionit të jetës.

Nëntoger Dajana Zenelaj 26 vjeçare, vjen nga një familje me origjinë nga Kuçi i Vlorës, është vajza e një koloneli ushtarak në Flotën Detare dhe vajza e një infermiereje. 9-vjeçaren e kreu në qytetin e Vlorës pranë shkollës "Muco Delo", gjatë kësaj periudhe ajo bën një shkëputje në vitet 2005-2007, ku klasën e pestë dhe të gjashtë e kreu në Stamboll, pasi i ati ishte duke kryer Akademinë Ushtarake atje. Shkollën e mesme e përfundoi po në qytetin e Vlorës në shkollën "Ali Demi". Lidhja me Turqinë nuk u shkëput, vite më vonë ajo u rikthye sërish për të ndjekur studimet për t'u bërë një mjekë ushtarake.

Nëntoger Hygerta Illica vjen nga qyteti i Peshkopisë, e lindur më 09.07.1996, ajo është fëmija i madh i familjes Illica, ka një vëlla dhe një motër më të vogël. Ashtu siç na tregon dhe vetë, ajo gjimnazin e përgjithshëm e ka kryer në komunën Maqellarë të Peshkopisë pas përfundimit të gjimnazit ajo konkurroi në

provimet e Ministrisë së Mbrojtjes. Si rezultat i provimeve filloi studimet në Turqi në Akademinë e Mjekësisë Ushtarake Gülhane në Ankara. Këtu filloi dhe rrugëtimi i sfidave, vështirësive, përshtatjes, por falë vullnetit të çeliktë tashmë ato kanë realizuar ëndrrën e tyre.

Detyra themelore e një mjeku është mbrojtja e jetës së pacienteve të tij, por të qenit mjek në ushtri e bën këtë profesion akoma dhe më shumë unik. Përse zgjodhët që rrugëtimi juaj profesional të ishte pikërisht mjekësi ushtarake?

Dajana Zenelaj: Të them të drejtën më ka pëlqyer përherë disiplina në ushtri, rregullat dhe disiplina janë shumë të rëndësishme. Pse mjekë ushtarake? Në Shqipëri shumë të rinj nuk e dinë në qoftë se ekziston një mjek ushtarak, çfarë pozicioni ka në ushtri dhe unë vetë nuk kam pas shumë informacion, por para se të filloja kam kërkuar dhe lexuar shumë në internet. Pothuajse çdo shtet ka mjek ushtarak të cilët duhet të jenë në vijën e parë të luftës edhe pse në ditët e sotme në shumë vende ekziston paqja. Ne përveç studimeve të mjekësisë gjithashtu jemi të përgatitur dhe nga ana ushtarake, sepse në fund të viteve 1.2.3.4 kemi bërë kamp

ushtarak ku dhe jemi stërvitur. Njëkohësisht dimë dhe sesi të menaxhojmë situatat ne qoftë se kemi një ushtarak të plagosur, sepse marrim leksione dhe bëjmë trajnime të veçanta vetëm për këto situata.

Hygerta Ilnica: Pas mbarimit të gjimnazit qëllimi im ishte të vazhdoja universitetin për një degë ku mund ta shikoja veten në të ardhmen. Mjekësia ka qenë gjithmonë një nga ato degë për mua. Kur mu dha mundësia të konkurroj pranë Ministrisë së Mbrojtjes, ideja e të jetuarit në një ambient ushtarak mu duk e përshtatshme.

Ju jeni rritur në një familje ushtarake, pasi babai juaj është kolonel në Flotën Detare dhe nëna juaj infermiere. Duket se keni zgjedhur një profesion që gërsheton atë të prindërve tuaj, a kanë qenë ata një shtysë për këtë zgjedhje?

Dajana Zenelaj: Po profesioni im është një gërshetim i profesioneve të prindërve të mi. Normalisht kanë ndikuar, sepse gjithmonë kam parë pjesën e disiplinës nga ana e babait dhe atë të humanizmit nga ana e nënës e cila është infermiere. I falënderoj që më kanë mbështetur në çdo hap të jetës time, secilin shqetësim timin e përjetonin dhe ata bashkërisht me mua.

Kur bëhet fjalë për arsimin mjekësor ushtarak, normat e pranimit në universitete mjekësore tregojnë se të jesh pjesë e tyre nuk është aspak e lehtë. Çdo të thotë kjo fitore për ju?

Dajana Zenelaj: Po përveç provimeve për të cilat duhet të studiosh, dhe vetë shkolla është e vështirë si nga ana fizike, kur bëhet fjalë për pjesën ushtarake ashtu dhe nga ana psikologjike, pasi është një universitet i vështirë. Ke të bësh me situata nga më të ndryshmet, plus largësisë nga vendi yt. Por jam shumë e kënaqur që kam mbaruar studimet në Fakultetin e Mjekësisë Gulhane. Besoj se ne si studentë të Shqipërisë kemi përfaqësuar vendin tonë më së miri duke u përshtatur me rregullat e disiplinën e ushtrisë turke, pavarësisht vështirësive që mund të kemi pasur.

Hygerta Ilnica: Normat dhe parametrat që kërkoheshin ishin të shumta. Kërkoheshin disa provime shtesë, ashtu si dhe ekzaminime shëndetësore. Unë gjithmonë kam dashur të jem e pavarur, të mund të fitoja të drejtën për studim pa munduar shumë familjen dhe fakti që e fitova këtë të drejtë ishte shumë domethënëse për mua.

E kishit menduar ndonjëherë t'i bashkoheshit ushtrisë para konkurimit për në universitet?

Hygerta Ilnica: Të them të drejtën jo, nuk kam qenë shumë e ambientuar

me ushtrinë më parë. Ama ishte një sfidë që e mora përsipër dhe nuk jam penduar.

Po tani ku i shihni sfidat tuaja më të mëdha?

Dajana Zenelaj: Sfida ime është të bëhem një mjeke sa më e denjë për veten dhe vendin tim. Të bëj trajnime sa më të ndryshme, pse jo dhe jashtë shtetit, për t'u aftësuar edhe më shumë.

Hygerta Ilnica: Sfida ime më e madhe është që gjithë këtë mund dhe sakrificë të mund ta përdor në mënyrën më të mirë të mundshme.

Sapo keni përfunduar studimet për mjekësi ushtarake, a keni men-



duar për një specializim dhe nëse po, cilën fushë të specializimeve keni zgjedhur?

Dajana Zenelaj: Normalisht si çdo mjek çdo kush fillon të mendojë për specializim që në vit të 5-të pa mbaruar ende. Në mendje kam 3 alternativa, por e para që kryeson është okulistika, uroj t'ia arrij të specializohem në këtë fushë.

Hygerta Ilnica: Jam e mendimit që pas gjithë këtij investimi që unë, familja ime dhe shteti shqiptar ka bërë për arsimimin tim, të mund të kthehem në Shqipëri si një mjeke e plotësuar dhe e specializuar. Kam përshtypjen që kam prirje në disa fusha më shumë se në disa të tjera, koha do ta tregojë.

Si është jeta e mjekeve femra në ushtri? A ka ndonjë ndryshim midis mjekeve civile dhe atyre që janë pjesë e Forcave të Armatosura?

Dajana Zenelaj: Siç e thashë dhe më sipër dikush nga jashtë nuk mund ta dijë këtë ndryshim pa a provuar. Mund të them si femër dhe mashkull në ushtri duhet të kesh karakter të fortë për të përballuar çdo situatë si nga ana mjekësore dhe ajo ushtarake.

Hygerta Ilnica: Të them të drejtën nuk jam shumë e informuar në këtë aspekt. Ama dua të mëndoj që jeta e një femre në ushtri është po aq frytdhënëse dhe e kënaqshme sa është dhe për çdo pjesëtar të Forcave të Armatosura.

Cila mendoni se është aftësia juaj për të përballuar sfidat si mjeke në Forcat e Armatosura, por dhe në

jetën personale?

Dajana Zenelaj: Këtë s'mund ta përkuftizoj me një fjalë, por kur të filloj punë në Shqipëri besoj se do të tregoj aftësitë dhe dijet e mia si mjeke ushtarake. Për sa i përket jetës personale, si çdo femër që është pjesë e Forcave të Armatosura, dimë t'i përkushtohemi karrierës, por duke mos lënë pas dhe familjen.

Çdo profesion ka të dyja anët e monedhës, sipas jush cilat janë avantazhet dhe disavantazhet e të qenit mjek në ushtri?

Hygerta Ilnica: Nëse do flisnim për avantazhe dhe disavantazhe mund të gjenden shumë. Ama nëse do t'i përmbledhja, do të thosha që një ndër avantazhet është që të jepet mundësia të studiosh në një ndër universitetet më të mira, me një kosto shumë të ulët. Gjithmonë e ndjen mbështetjen e shtetit. Si disavantazh mund të përmend faktin që si mjek ushtarak je i lidhur me shtetin dhe ashtu siç mund të përfitosh nga shumë mundësi, mund të humbasësh dhe të tjera.

Tashmë jeni në pritje të emërimit, ju si mjeke keni ndonjë preferencë?

Dajana Zenelaj: Preferencë nuk është se kam, thjesht do të doja të kisha një vend pune ku të shfaqja aftësitë e mia si mjeke ushtarake, pse jo dhe në spitalin e ri të Fierit ku shumë mjekë shqiptarë punojnë me stafin turk. Ne kemi fituar aftësitë dhe dijet nga profesorët turk dhe këto aftësi dhe dije mund t'i ndajmë me stafin e doktorëve shqiptarë, plus gjuhën turke e zotërojmë më së miri.

Hygerta Ilnica: Unë dua vetëm një vend me kushtet e mjaftueshme ku të mund të ushtroj ato që kam për të ofruar.

Na tregoni pak më shumë për punën dhe përgjegjësitë tuaja të përditshme.

Dajana Zenelaj: Punë në Shqipëri akoma skam filluar, por në Turqi normalisht pjesa më e madhe kalon në spital pasi në vit të fundit ne kemi vetëm praktikë. Qëndrojmë dhe si mjek roje, kjo na bën të aftësohemi në çdo gjendje urgjente që mund të vijë.

A ka diçka që dëshironi ta ndani me lexuesit e gazetës "Ushtria"?

Hygerta Ilnica: Prurëtimi që kemi bërë ne mund të duket i gjatë dhe i frikshëm nga këndvështrimi i njerëzve të ndryshëm. Dua të inkurajoj çdo të ri ose të re, që ka dëshirën të bëhet mjek të vlerësojë dhe statusin mjek ushtarak. Gjithashtu dua të inkurajoj dhe shumë të rinj të tjerë të bëhen pjesë e Forcave të Armatosura, sidomos vajzat. Ashtu si në çdo aspekt të jetës, gjithmonë do të kemi nevojë për vajza të forta dhe të zonja si në ushtri ashtu dhe në mjekësi.

Uniforma Ushtarake,

Kjo Përfaqësi Historike në kohë lufte dhe paqe

Studimi për uniformat në Forcat e Armatosura, ku kontribuuan komandat e FT, FA, FD, me specialist të logjistikës, dhe pas përfundimit të mostrave për çdo armë e shërbim, me të gjitha dekoracionet sipas gradave të armëve dhe shërbimeve, u miratua me Vendim të Këshillit të Ministrave

Figura e Ali Pashë Tepelenës, e trajtuar si një figurë me impakt të fuqishëm, në gjallje të tij u pa si një “despot oriental” nga turistët europianë apo dhe studiuesit historikë. I ndikuar nga influenca e rrymës së Filo-Helenizmit që mbizotëronte në atë kohë por dhe në kundërshtim me çfarë shprehte popullsia greke, ai konsiderohej si dhunues dhe shtypës i asaj që kishte mbetur nga Greqia e Lashtë.

Gjatë shekujve të mëparshëm popullsia shqiptare në përgjithësi kishte qenë një element force, ndaj të gjitha Fuqitë e Mëdha me të cilat Ali Pasha hyri në marrëdhënie diplomatike u përpoqën ta përdornin në kundërshtitë që kishin me njëra-tjetrën në rajon, por kurrë nuk i dhanë mbështetjen e duhur diplomatike, për të shpallur pavarësinë.

Veshja e ushtarit shqiptar të kohës së Ali Pashë Tepelenës ishte një kombinim midis petkave të lehta dhe fustanellës e cila u mbajt edhe në uniformën e Regjimentit “Gjuajtësit e Orientit” të formuar në ishujt Jonianë më 1807.

“Gjuajtësit e Orientit” ishte një regjiment i formuar kryesisht nga suljotët dhe nga shqiptarët e tjerë jashtë vendit, që ofronin shërbimin tradicional të mercenarit por të



Tefik Mborja dhe hierarkët fashistë shqiptarë në vitin 1941, me veshje të njehta me ato të “kolëgeve” Italianë



Nga ekspozita e vitit 2002, “Shteti shqiptar në uniforma”, çelur pranë Galerisë së Arteve në Tiranë



Anëtarë të misioneve britanike në vitet 1943-44 dhe krerë nacionalistë shqiptarë

cilët edhe kishin braktisur vendet e tyre si rezultat i armiqësive që kishin pasur me pushtetin e centralizuar të Ali Pashë Tepelenës.

Fustanella shqiptare, e cila duke qenë më shumë e pëlqyer mes popullsisë të Ballkanit u imitua më shumë nga popujt e tjerë më të largët. Me këtë veshje disa udhëtarë të huaj në XVIII-XIX vërejnë se ishin të veshur trupprojat e oborreve princërore të Moldavisë, të Vllahisë në Bukuresht. Gjithashtu Major William Martin Leak, përfaqësues i Anglisë në Janinë, që kishte pasur mundësinë t'i vizitonte para Bajronit këto zona, kishte shkruar që në 1805: "Veshja shqiptare po bëhet përditë e më e zakonshme, si në More edhe në pjesët e tjera të Greqisë, në këtë të fundit për shkak edhe të rritjes së madhe të fuqisë shqiptare. Kjo veshje është më e lehtë dhe më e volitshme se ajo turke ose greke". Të gjitha këto dëshmi hedhin dritë mbi influencën dhe "ekspansionin" etnografik, nëse mund ta quajmë kështu, të shqiptarëve që duke qenë elita ushtarake e Pashallëkut të Janinës, përveç zakoneve dhe mjeshtërive të tyre të luftimit u kishin imponuar nga ana estetike dhe veshjen e tyre kombëtare popullsisë të tjera në Ballkan.

Ndikimet dhe fryma kombëtare në uniformat e Ushtrisë Shqiptare

Qeveria e Përkohshme e Vlorës



dhe veprimtaria e saj, 28 Nëntor 1912-1922, lëshoi udhëzime për të mbajtur në përdorim veshjen e ish-xhandarmërisë apo të ushtrisë turke. Për t'u dalluar që ishin në shërbim të Qeverisë Shqiptare, këtyre veshjeve iu qepën sipër jakave shirita kuqezi, kurse në kapele (qeleshe) një shqiponjë të zezë. Në pamundësi të tyre u udhëzua që në krah të vendosej një shirit kuqezi që përfaqësonte simbolin kombëtar shqiptar.

Më 1913, qeveria mori masa të mëteja si uniformë atë të përshtatshmen, dalluesen e xhandarmërisë së sapoformuar. Veshja me të cilën u pajis xhandarmëria shqiptare, për arsye të shpjegueshme për atë kohë si dhe për faktin se nuk ishin ideuar apo qepur në Shqipëri, nuk kishte veçori apo karakteristika kombëtare, në prerje apo në qepje. Ajo ishte uniformë ushtarake italiane me ngjyra gri-jeshile, kapela (kësula ushtarake) ishte pa strehë, gradat ishin vendosur në pjesën e përparme të jakës së xhaketës, për oficerët me yje, për nënoficerët dhe tetarët me shirita mëndafshi me ngjyrë të verdhë. Për t'i dhënë kësaj uniforme një karakter dallues kombëtar jaja ishte punuar me copë kuqezi.

Imitimi i sllavëve dhe sovjetikëve Kohët që pasuan sollën veshje, të cilat ishin një përshtatje e atyre të "aleatëve" apo "padronëve të radhës", duke ia nisur që nga Italia e deri tek Kina. Fotot që po botoj, e ilustrojnë më mirë këtë pretendim,

ndërsa sheh për shembull, ushtarakë shqiptarë në dy kohë të ndryshme, si ajo e Zogut dhe ajo e monizmit, në dekadën e "miqësisë së pathyeshme" me ish-Bashkimin Sovjetik, ku fare lehtësisht mund të besosh se sheh anëtarë të Ushtrisë së Kuqe, e jo shqiptarë.

Më parë, menjëherë pas Luftës, uniforma e Ushtrisë Shqiptare (por edhe e Policisë dhe Sigurimit) do të ishte një kopje 100% e asaj jugosllave, ku pustina do të vijonte të qëndronte edhe më tej në kohë.

Uniformat kineze

Më vonë do të viheshin re edhe tendencat kineze në uniformat shqiptare, që do të sillnin veç të tjerash, edhe një "risi" ekstreme në



këtë aspekt: do të hiqnin fare gradat e oficerët mund t'i ngatërroje lehtësisht me ndonjë karrocier. Kjo marrëzi vijoi deri në rënien e regjimit në vitin 1991.

Veshja fashiste u përdor edhe pas rënies së Italisë

Por para saj, do të mbizotëronte ajo e Ushtrisë Fashiste, veshje me të cilat do të shiheshin rëndom jo vetëm hierarkët fashistë shqiptarë, por edhe anëtarët e Milicisë. Më 18 shtator 1939, Jakomon nënshkroi dekretin për krijimin e milicisë fashiste, një nga organizmat e parë të Partisë Fashiste Shqiptare. Kjo strukturë bënte pjesë në Milicinë Vullnetare për Sigurimin Kombëtar. Kjo milici "garantonte zhvillimet e revolucionit fashist", por angazhohej edhe si trupë elitare në kuadër të ushtrisë. Megjithatë në to shihen qartë edhe simbole kombëtare, si plisa apo qeleshe, e madje shkonte edhe më tej, kur sheh se anëtarët e "Gardës Mbretërore" (Guardia Reale Albanese) parakalonin në mes të Romës, të veshur tërësisht në kostume kombëtare shqiptare. Më tej, ndërsa oficerët do t'i riktheheshin uniformave të monarkisë (duke u hequr sidoqoftë simbolin e Zogut) ushtarët e Ushtrisë Kombëtare të ringritur gjatë kohës së Regjencës gjatë periudhës së pushtimit gjerman, pas kapitullimit të Italisë, do të vijonin t'i mbanin në pjesën më të madhe për nevoja utilitare uniformat e ushtrisë italiane, tashmë me emblemën e "shtetit të ripavarësuar" shqiptar.

Partizanët dhe nacionalistët përdorën xhaketat angleze

Ndër partizanët, madje ndër forcat nacionaliste, do të shiheshin rëndom uniformat britanike, të parashutuara si ndihma nga aleatët në Luftë ndaj gjermanëve. .

Postmonizmi dhe kamuflazhet e të gjitha ngjyrave

Periudha e demokracisë do të shihte shumëllojshmëri uniformash që reflektonin edhe varësinë e Ushtrisë Shqiptare nga ndihmat e ushtrive mike, pa mundur të krijohet dot një model që reflektonte traditën shqiptare. Shihje rëndom në vitet '90 kamuflazhe lara-lara e eksperimente të dështuara

për të unifikuar, sistemuar e organizuar më mirë punën në këtë aspekt, por do të duhej të kalonin shumë vite derisa të vihej re një tendencë pozitive, edhe pse ajo reflekton sërish një qasje (edhe pse jo negative) imituese përballë aleatëve tanë strategjikë.

Aktualisht, prej vitesh, sidomos pas anëtarësimit në NATO, vihet re një disiplinim edhe në këtë aspekt, duke sjellë më shumë dinjitet e seriozitet për Forcat tona të Armatosura. Në vitin 2002, u hap Ekspozita "Shteti shqiptar në uniforma".

Siç do të kujtonte më vonë studiuesi Artan Lame, "Në dhje-



njerëz në Galeri me dëshirën për të parë ekspozitën që nuk ishte më".

Pranë Akademisë së Mbrojtjes, në kuadër të përmirësimit dhe kompletimit të uniformave ushtarake ngrihet grupi i punës

Në vitin 2004-2005 u bë një studim për uniformat në forcat e armatosura, ku kontribuuan komandantët e FT, FA, FD, me specialist të logjistikës, dhe pas përfundimit të mostrave për çdo armë e shërbim, me të gjitha dekoracionet sipas gradave të armëve dhe shërbimeve, u miratua me Vendim të Këshillit të Ministrave. Mbi këtë bazë u përgatit albumi i forcave të armatosura të Republikës së Shqipërisë, një punë shkencore dhe kombëtare,



tor 2002, me rastin e 90-vjetorit të Ushtrisë, u hap në Galerinë e Arteve, Ekspozita "Shteti shqiptar në uniforma".

"Shteti shqiptar vuri në dispozicion djelmoshat e Gardës dhe korentin, unë vura në dispozicion koleksionin tim të uniformave dhe... rezultati. Ekspozita qëndroi e hapur vetëm 4 orë, aq sa mund të rrinin pa ngrënë djemtë e mrekullueshëm të Gardës. Megjithatë ishte një sukses i jashtëzakonshëm dhe, për ditë me radhë, vijuan të shkonin

mbi bazën e traditës shqiptare, përshtatur dhe me uniformat e NATO-s.

Është punuar në vite që të shkohet drejt një standardizimi të plotë të uniformës dhe së fundmi është mbledhur grupi i punës me specialistë të fushës, për rishikimin e modelit të uniformave, për përmirësimin, hartimin dhe kompletimin e dizajneve, stilimeve, treguesve teknik të uniformave ushtarake, stemave, simboleve dhe shenjave të tjera dalluese të unifor-

mës ushtarake që mban personeli ushtarak i Forcave të Armatosura të RSH. I miratuar me V.K.M nr. 694, datë 21.11.2018 si dhe ato që kanë qenë pjesë e V.K.M nr. 503, datë 13.7.2011 me synim, sigurimin e një prezantimi dinjitoz të ushtarakut të FARSH, mbartjen e simbolikave që evidentojnë identitetin kombëtar dhe sigurimin e lirshmërisë së personelit në kryerjen e aktiviteteve të ndryshme të përditshme, gjatë stërvitjeve dhe operacioneve brenda dhe jashtë vendit të uniformës ushtarake që mbajnë FARSH.

1. Rregullorja e Uniformave Ushtarake të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë është akti normativ me të cilin rregullohet veprimtaria e strukturave të FA-së, në lidhje me përdorimin e uniformave, rregullat e përdorimit të tyre si dhe pamjen e jashtme të personelit ush-



tarak të FA-së.

2. Rregullorja trajton kriteret dhe rregullat të përgjithshme për përdorimin e uniformës së FA-së, llojet e uniformave sipas qëllimit të përdorimit, kompetencat dhe përgjegjësitë e strukturave ushtarake

Në të gjitha nivelet e komandimit të FA-së, në raport me zbatimin



e kësaj rregulloreje.

3. Rregullorja trajton në mënyrë specifike llojet e stemave të Ministrisë së Mbrojtjes dhe institucioneve të varësisë, flamujt dekorativë të njësive kryesore të FA-së.

4. Rregullorja trajton qartazi përdorimin e uniformës ushtarake ceremoniale nga ushtarakët e dalë në rezervë dhe veteranët e luftës, gjatë kohës kur ata marrin pjesë në ceremonitë kombëtare dhe lokale, përvjetorë që organizohen nga njësia ku kanë shërbyer, ceremonitë e betimit, kortezhe të përmotshme, festa familjare.

Veshja e uniformës ceremoniale me medaljet përcaktohet me urdhër të komandës së njësisë ose garnizonit ushtarak. Uniforma e Forcave Territoriale kur përdoret në stërvitje dhe kohë lufte, mund të vishet edhe uniformë e përzier (civile-ushtarake) sipas rasteve dhe nevojave operative.

Uniforma ceremoniale për efektivin e Orkestrës Frymore dhe për Truprojën e Nderit, vishet vetëm në raste pritje zyrtare dhe me urdhër të veçantë.

Ministri i Mbrojtjes ka të drejtë të caktojë se cilët ushtarakë mund të mbajnë veshje civile në vend të uniformës ushtarake.

Oficerët e Forcave të Armatosura që nxirren në rezervë ose pension me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes për raste invaliditeti, plotësim moshe, arsye shëndetësore, shkurtim organike dhe transferim në sektorë të tjerë civilë të pushtetit, kanë të drejtë të mbajnë uniformën ushtarake (me shenjën dalluese në supë), të përcaktuar me urdhrin e daljes në rezervë ose pension.

Burime të marra nga:

1) z. Dorian Koci, studiues i historisë, Drejtor i Muzeut Historik Kombëtar.

2) z. Artan Lame, studiues i historisë shqiptare.

3) z. Asllan Zemani (drejtor i Muzeut Ushtarak, historian).

4) Rregullorja e Uniformës të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

**Punoi:
Anjeza Musollari**

Akademia Ushtarake

Smaçi: Jemi në fazën më të mirë të transformimit të arsimit ushtarak në veçanti në nivel universitar

Intervistë

me Dr. Etleva

Smaçi, zëvendës

dekane e

Fakultetit të

Mbrojtjes dhe

Sigurisë

INTERVISTOI
ANJEZA MUSOLLARI

Znj. Smaçi, arsimimi ushtarak në Shqipëri është një shtyllë e rëndësishme në edukimin kombëtar. Që nga shkolla e parë, e cila u hap për nevojat e organizimit dhe drejtimit të xhandarmërisë shqiptare, më 1919 dhe deri në ditët e sotme arsimit ushtarak ka shërbyer si një gjenerator për përgatitjen e kuadrit ushtarak. Akademia Ushtarake si Institucion i Arsimit të Lartë e ka zanafillën që në vitin 1957, kur u themelua edhe Universiteti i Tira-

nës. Në rrugëtimin e tij, ky institucion arsimor ka njohur disa transformime në kontekstin e kohës ku ato kanë ndodhur. E megjithatë ai nuk ka reshtur kurrë së kryeri misionin e tij, edukimin patriotik të të gjithë brezave që i kanë shërbyer dhe vazhdojnë t'i shërbejnë mbrojtjes së vendit dhe sigurisë kombëtare.

Në Konceptin e Arsimit të FA-ve, ky proces si dhe ai i trajnimit, stërvitjes dhe vlerësimit konsolidohen më tej, në përputhje me standardet më të përparura të NATO-s dhe objektivi kryesor i këtij sistemi mbetet mbështetja e Forcave të Armatosura me personel profesional për përmbushjen e të gjithë spektrit të detyrave operacionale. Ai duhet t'i nënshtrohet një transformimi të thellë, ku përparësi mbetet përgatitja e ushtarit profesionist, nënoficerit, oficerit të trupës e shtabeve dhe civileve të FA-ve për të gjitha nivelet.

Cili është faktori bazë i vijimësisë së arsimit bashkëkohor ushtarak?

Arsimi ushtarak nuk është një risi në sistemin tonë arsimor. Më vjen mirë që edhe ju, në pyetjen tuaj keni përdorur si term konceptin e "vijimësisë". Pra, shfrytëzimi i elementit tradicional, ose asaj që shpesh herë ne e konsiderojmë si "shkolla e vjetër/apo shkolla klasike" ngjallet një element bazë. Kjo do të thotë që edhe arsimit bashkëkohor ushtarak duhet të ketë si shtyllë kryesore edukimin patriotik të profesionistëve të rinj në fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë. Krijimi i një vakumi prej gati 15 vitesh, që erdhi si pasojë e mbylljes së arsimit të lartë ushtarak në vend, tregoi se pavarësisht përgatitjes së lartë profesionale të oficerëve të rinj në akademitë më prestigjioze të vendeve partnere, fryma atdhetare e tyre ishte një element i munguar. Në ndryshim nga studentët tanë të Bachelor-it, të hapur



në shtator të vitit 2020, që çdo mëngjes këndojnë himnin kombëtar, ky grupim ushtarakësh për fat të keq nuk e morën dot këtë edukim. Prandaj, që vijmësia të jetë e suksesshme dhe e qëndrueshme duhet të kontribuojmë të gjithë në forcimin e arsimit ushtarak vendas, duke marrë më të mirën e asaj që tradita na ofron.

Si është transformuar arsimit ushtarak në vite, cilat janë objektivat e AFA-së në këtë drejtim?

Ju e keni prekur pak në hyrje të kësaj interviste idenë se arsimit ushtarak në Shqipëri është transformuar që nga fillimet e tij. Kjo është më se e kuptueshme pasi qëllimi kryesor i përgatitjes së oficerëve përgati 50 vite ishte mbrojtja e vendit nga armiqet e jashtëm dhe të brendshëm. Me ndryshimet demokratike në vend u pa realisht se këta armiq ishin imagjinarë. Për rrjedhojë si gjithë FA-të edhe shkollat ushtarake hynë në proces transformimi. Nuk ka qenë një rrugëtim i lehtë. Numri i studentëve në shkollën e lartë ushtarake ra ndjeshëm. Kjo pasi edhe FA vetë u reduktua vit pas viti. Për sa i përket formave të shkollimit ka pasur disa përpjekje për ta afruar me arsimin civil publik. Le të kujtojmë për shembull nismën e hapjes së Universitetit Ushtarak në vitin 2004, ku u tentua modeli i dhënies së diplomave të dyfishta, pra diplomë në fushën ushtarake dhe diplomë universitare në një profil të caktuar si ekonomi, informatikë etj.

Sot më lejoni të them modestisht se jemi në fazën më të mirë të transformimit të arsimit ushtarak në veçanti në nivel universitar. E them këtë pasi për herë të parë kemi të njëjtën formë të diplomës së nivelit të parë Bachelor si të gjithë universitetet e tjera në vend. Pra japim një diplomë trevjeçare në Shkenca Ushtarake, e licencuar nga MARS me 180 kredite, që i mundëson çdo të riu/të reje të vazhdojë studimet e nivelit të dytë master, në fusha të njëjta ose të përafërta. Aktualisht ne jemi duke punuar në përgatitjen e programeve për Master Profesional dhe Master Shkencor me fokus politikë të Mbrojtjes dhe Sigurisë. Ky është një angazhim por edhe detyrim moral që ne kemi

ndaj studentëve që ata të ndihen të barabartë si të gjithë kolegët e tyre ushtarak në vendet e NATO-s, por edhe me studentët e IAL publike që ndjekin shkollimin sipas modelit 3+1 ose 3+2. Diplomati e lëshuara nga AFA janë në përputhje me kërkesat e Kartës së Bolonjës e njohur në zonën Europiane. Në proces transformimi padyshim AFA dhe FMS do të synojnë për herë të parë në vitin akademik 2021-2022 që me dy programet e reja të studimit të nivelit të parë Bachelor, "Teknologji Informatik në Fushën e Mbrojtjes" dhe "Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes" të orientohet drejt zhvillimeve dhe trendeve të reja edhe në fushën e Mbrojtjes, ku dihet tashmë se teknologjia luan një rol vendimtar.

Unë u ndala pak gjatë tek studimet e nivelit të parë, pasi siç e theksova edhe më lart, ato u finalizuan pas një mungese të gjatë në arsimin e lartë ushtarak me kontributin institucional dhe mbështetjen dashamirëse të Ministrisë të Mbrojtjes dhe Ministrisë të Arsimit duke e rikthyer FA-në në një aktor të rëndësishëm edhe në fushën e edukimit. Për të justifikuar këtë mbështetje është detyrë e AFA-së që me politikë të saj arsimore ta bëjë sa më tërheqës institucionin për të tre nivelet e studimit, jo vetëm për ushtarakët por edhe për civilët që tregojnë interes dhe duan të thellohen në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes.

Zonja Smaçi, ndërsa ju po flisni për transformimin, mua natyrshëm më shkojnë mendja tek një ndër elementet thelbësorë që përcaktojnë transformimet në sistemet arsimore. E kam fjalën për kurrikulën. Për lexuesin unë do të doja që ju të jepnit një panoramë më të gjerë në lidhje me kurrikulën në arsimin ushtarak. Si përzgjidhet dhe zbatohet ajo?

Kurrikula, si një koncept i përgjithshëm nënkupton një sistem të përbërë nga disa elemente me synime arsimore që në bashkërendim me njëra-tjetrën krijojnë mundësi të funksionimit të sistemit arsimor. Vetë kurrikula është një koncept ciklik në ndryshim të vazhdueshëm, pasi ajo është e kushtëzuar drejt për drejt nga konteksti shoqëror,

politik, ekonomik dhe së fundmi teknologjik i mjedisit arsimor në të cilin prodhohet dhe konsumohet. Në këto kushte, nevoja për ndryshime kurrikulare që synojnë kompetencat, rishfaqet gjithnjë e më shpesh si domosdoshmëri në fushën e politikave arsimore, ndaj përbën thelbin e reformave në edukim në përgjithësi dhe atyre kurrikulare, në veçanti.

Në rastin e arsimit ushtarak, nisur nga natyra e tij unike ndryshimet e kurrikulës në këtë fushë harmonizojnë jo vetëm strategjinë arsimore por edhe strategjinë kombëtare të sigurisë. Andaj dhe qasja ndaj kurrikulës së arsimit ushtarak mbetet një domein paksa i "ngurtë" në raport me kurrikulat e arsimore në përgjithësi. Në arsimin ushtarak kurrikula është një ndër shtyllat kryesore dhe pjesë integrale e ndërtimit të ushtrisë si një institucion me mision shumë të rëndësishëm dhe unik, siç është mbrojtja dhe siguria kombëtare. Nga ana tjetër fakti që ushtarakët tanë i ushtrojnë kompetencat dhe aftësitë e tyre në një mjedis sigurie kompleks kërkon që qasja ndaj arsimimit të jetë multidisiplinare. Kjo do të thotë që aftësimi profesional është vetëm një shtyllë e kurrikulës. Shtylla tjetër shumë e rëndësishme është aftësimi i tyre me kompetenca që zhvillojnë një qytetar me bindje demokratike dhe integritet në publik.

Aktualisht pothuajse në të gjitha akademitë ushtarake perëndimore kurrikula përfshin lëndë akademike që përqendrohen në politikën moderne dhe zhvillimet ushtarake, në lidhjen e ngushtë midis qëllimeve politike dhe përdorimit të mjeteve ushtarake. Integrimi arsimor i historisë, kulturave të huaja, marrëdhëniet ndërkombëtare, shkenca operationale ushtarake dhe e drejta humanitare i shërben një objektivit të thjeshtë: për të prodhuar një klasë të mirë informuar ushtarake. Këtë ka synuar edhe AFA që prej momentit që u hodh ideja e rikthimit të nivelit të parë të studimeve Bachelor në FMS. Them se kurrikula jonë është e ngjashme në elementet më të rëndësishme me shkollat e tjera të larta të vendeve aleate. Sfidë ngelet padyshim orientimi i saj drejt teknologjisë në kushtet kur armiku nuk është më ai klasik. Së fundmi, pandemia ishte sfida e radhës që ngriti pyetjen si

duhet të trajnohet dhe arsimohet një ushtarak për t'u përballur me të ardhmen e paparashikueshme ku armiku është i padukshëm?! Për ta përmbyllur, sfidat intelektuale dhe kulturore janë ato që do të përcaktojnë ndryshimet kurrikulare, krahas vizionit politik për kompetencat e ushtarakut të shekullit të 21-të.

AFA dhe FMS krahas ciklit bachelor, që nisi në shtator të vitit 2020, përgatit oficerë të rinj edhe përmes kurseve, siç është kursi njëvjeçar i Përgatitjes së Oficerit të ri. Cili është dallimi mes këtyre dy modeleve arsimore?

Kjo është një pyetje interesante sepse hedh dritë edhe mbi dilemat apo debatin që vetë rrethet ushtarake kanë. Si duhet të përgatiten oficerët e rinj? Të ndjekin një shkollë të lartë 3 vjeçare në nivelin e parë bachelor e më pas të titullohen oficerë, apo të përfundojnë shkollimin civil në profile të ndryshme e më pas të kryejnë një kurs njëvjeçar e në fund të tij të titullohen oficerë. Në fakt ne për herë të parë në këtë vit i aplikuam të dyja modelet. Përmes maturës shtetërore ne pranuan në vitin e parë të bachelorit Shkenca Ushtarake 60 maturantë. Po kështu përmes aplikimit në QPR u pranuan 60 të rinj që kishin përfunduar studimet e larta në profile të ndryshme në KPO, kurs njëvjeçar. Pra, në këtë rast përfitimi i FA-së është se këta të rinj janë tashmë të diplomuar dhe ne përpiqemi t'u japim përparësi në përzgjedhje atyre të rinjve që kanë profesione për të cilat FA ka nevojë. Interes paraqesin të diplomuarit në degët e TIK, ekonomisë apo edhe në shkencave të tjera ekzakte si p.sh., kimia etj. Edhe pse programi është i shkurtuar nga pikëpamja kohore në raport me studentët që përfundojnë Shkencat Ushtarake, ai është i ndërthurur bazuar në modelet më të mira të kurseve të ngjashme, që zhvillohen në SHBA si p.sh., ato të Gardës së New Jersey-it.

Edhe për vitin akademik në vijimësi në AFA/FMS do të vazhdojë arsimimi qoftë në nivelin e parë të studimit qoftë në KPO. Nisur nga nevojat që FA do të ketë për efektive, me daljen e kuadrove të para nga Bachelor Shkenca Ushtarake, ndoshta do të kemi një pakësim të

rekrutimit të të rinjve që janë të diplomuar. Këtu do të ndikojë edhe fakti që FMS do të ketë që prej tetorit të vitit 2021 tre programe studimi, dy prej të cilëve do të jenë në bashkëpunim me Universitetin Aleksandër Moisiu dhe ku gati më shumë se 50% e kurrikulës është e orientuar jo vetëm nga teknologjia por edhe me një qasje më civile.

Ju përmendët pak më lart



rekrutimin. Ky është një proces transparent që e zhvillon QPR. Ajo që unë mendoj se në këtë moment ka interes për publikun është padyshim procesi i pranimeve në shkollat e larta ku bën pjesë edhe FMS. Cilat janë disa nga rrugët apo politikat që AFA/FMS ndjek për të zgjuar interesin e të rinjve për këtë fakultet të ri të shtuar në listën e shkollave të larta në vendin tonë?

Së pari, do të doja të qartësoja faktin se maturantët që aspirojnë të ndjekin një shkollë të lartë ushtarake duhet së fillim të na përzgjedhin. Përse e them këtë? Pranimi në FMS ka specifikat e tij. Por hapi i parë është zgjedhja në formularin e maturës shtetërore e programeve që ne ofrojmë. Vetëm pas kësaj përzgjedhjeje ata mund të bëhen pjesë e garës, e cila pasohet me testimin fizik, intelektual dhe sigurisht disa kritere të tjera specifike që lidhen me aftësitë shëndetësore apo dhe parametrat fizikë.

Është e kuptueshme që në kohë paqeje roli i FA-së është pak në "hije", kështu në ndryshim me një punonjës policie që është më prezent në komunitet, ushtaraku edhe për nga misioni që ka është më i rezervuar. Kjo bën që ky profesion të mos ketë njohjen e duhur. Për shkak që edhe kurrikula e arsimit të mesëm e të lartë ka pak njohuri për mbrojtjen, madje ato kanë më tepër natyrë historike, maturantët janë

pak të paqartë se çfarë përfaqëson në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve profesioni i ushtarakut.

Prandaj, edhe pse në kushtet e vështira të pandemisë, është synuar që nëpërmjet rrjeteve sociale të paraqiten episode vizive nga jeta ushtarake. Të sillen më afër tek maturantët, ushtarakët e rinj në veçanti që kanë marrë pjesë në misione apo shtabe jashtë vendit. Mendoj se ky vit do të ketë një bum kërkesash, pasi zhvillimi i Defender 21 dhe ditët e hapura ishin një shans shumë i madh për ne por edhe për vetë maturantët për të hyrë sado pak në misteret e Artit Ushtarak.

Shpresojmë shumë që në këtë vit të mund të jemi më të pranishëm në të gjitha gjimnazet e Shqipërisë. Kjo do të jetë edhe një sfidë, jo thjesht të tërheqim maturantë, por të tërheqim më të mirët. Sepse ka një objektiv të formuluar qartë nga Ministri i Mbrojtjes z. Niko Peleshi, që AFA t'i përngjasojë në shëmbëlltynë akademisë më prestigjioze në botë West Point.

Për sa i përket pyetjes suaj përse maturantët duhet të na zgjedhin, padashur të përsëris disa nga përfitimet që ata kanë, do të thosha së pari, se profesioni i ushtarakut është një profesion elitare kudo në botë. Ai lidhet ngushtësisht me atdheun, patriotizmin, virtyte që jo çdo profesion i përçon. Gjithashtu koncepti i këtij profesioni nuk është më në suazën e ngushtë të vendit. Anëtarësimi në NATO dhe mbrojtja kolektive ka bërë që ushtaraku shqiptar të jetë një kontribuues real në mbrojtjen dhe sigurinë e Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut. Mendoj se çdo i ri do ta shihte si një mundësi të artë që të ndërtonte jo thjesht një karrierë kombëtare por edhe ndërkombëtare. Dhe shanset në FA, përmes posteve dhe detyrave të

jo thjesht me njohuri ushtarake por krijimit të një kulture të gjerë, kur njohja e organizatave ndërkombëtare dhe gjuha angleze janë elemente shumë të rëndësishëm. Për sa i përket gjuhës angleze, por jo vetëm asaj, AFA ka të përfshirë në strukturat ndihmëse akademike Qendrën e Gjuhëve të Huaja. Ky është edhe një tjetër përfitim i çdo studenti që vjen në shkollë të lartë ushtarake. Ai nuk shpenzon asgjë po kështu edhe ushtarakët e tjerë nga buxheti i tij për mësimin e gjuhëve të huaja. Ato mbulohen tërësisht me buxhetin e MM. Mësimdhënia e gjuhëve të huaja bëhet me profesionistë të fushës, pjesa më e madhe e të cilëve janë trajnuar në qendra të ngjashme në Amerikë, Angli, Gjermani etj. Njohja e anglishtes dhe gjuhëve të huaja

mungon dëshira dhe ka vullnet dhe projekte tepër ambicioze në këtë drejtim. Ashtu si ka përpjekje shumë të mira edhe për të pasuruar bazën materiale mësimore me tekste të përgatitura nga vetë stafi akademik, duke ju kthyer traditës së librit dhe jo përkthimeve shabllon. Të gjitha këto synojnë që akademianë të mos ketë imazhin e një reparti rutinë por të një qendre arsimore kërkimore me standarde kombëtare e pse jo dhe ndërkombëtare.

Së fundmi, do të doja t'ju drejtoja një pyetje pak më personale. Ju jeni civile, Dr. shkencash në Histori, me specialitet Histori Ushtarake dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare. Prej disa muajsh jeni edhe zëvendës dekane e FMS. Si e gjeni veten në këtë mjedis?



ndryshe që ajo ofron që në shkallët më të ulëta të gradave, janë shumë më të mëdha.

Meqë ju përmendët karrierën ndërkombëtare, që tashmë nuk është më një "tabu" në FA, si i përgatitni studentët tuaj, jo vetëm ata të Bachelor-it por edhe ushtarakët që ndjekin kurse institucionale të karrierës për një kulturë komunikimi sa më të mirë kur shkojnë në misionet, përfaqësi apo shtabe të NATO-s?

FA-të janë shembulli më i mirë i edukimit gjatë gjithë jetës. Në periudha të caktuara me distancë pas përfundimit të shkollës së lartë ata rikthehen në auditorë për periudha të ndryshme kohore që variojnë nga tre muaj deri në një vit, sipas natyrës së kursit dhe hierarkisë së gradës. Këto kurse institucionale i shërbejnë pikërisht përgatitjes së studentëve,

nuk konsiderohet privilegj në FA por detyrë.

Ç' mund të na thoni për kapacitetet logjistike që ju si Fakultet zotëroni. A janë ato të përshtatshme për një mësimdhënie sa më efektive?

Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë si "rishtar" kishte sivjet 60 studentë Bachelori. Por në të njëjtët auditorë bënte mësim edhe KPO. Për vitin akademik 2021-2022 janë planifikuar të jenë në auditorë edhe 120 studentë të tjerë që do të thotë trefishim i tyre. Mjediset akademike janë të pamjaftueshme. Ndihet nevoja për një kampus studentor. Jo vetëm për klasa dhe kabinete, por edhe për ambiente sportive ku studentët të kalojnë kohën e lirë. Kampusi studentor është pjesë e dinjitetit të një shkolle elitë, aq më tepër shkolle ushtarake. Nuk

Po është e vërtetë që pjesën më të madhe të karrierës sime akademike e kam zhvilluar jashtë mjedisit ushtarak. Fillimet në vitin 2015 kanë qenë një sfidë, edhe pse jam vajzë ushtaraku dhe disa e njihja natyrën e këtij profesioni. Edhe për sa i përket angazhimit profesional fokusi kryesor kishte qenë Filologjia dhe Historia e Përgjithshme. Ardhja në Akademi fillimisht si pedagogje ka qenë një mundësi e jashtëzakonshme për

të hulumtuar në Arkivin Qendror të FA-së. Historia Ushtarake njihet pak te ne. Edhe ata që kanë punuar për vite të tëra në këtë fushë janë pak të përmendur. Ky fakt më ngacmon vazhdimisht si kërkuese shkencore të hap një dritare më të madhe që Akademia të mos ngelet vetëm brenda mureve të garnizonit Skënderbej.

Si zëvendës dekane, kam pasur nderin të jem e para grua dhe civile në këtë detyrë. Nuk është e lehtë kur rrethohesh me kolegë ushtarakë karriere por që janë tepër mbështetës. Unë e kam parë këtë detyrë edhe si një frymë që ndihet kudo në FA në kuadër të nismave të barazisë gjinore, sidomos në nivelet e larta të drejtimit. E kam parë edhe si një filozofi të lidhshëm për ta hapur akademianë përtej rrethëve ushtarake dhe për t'u dhënë atyre lininë akademike që

Familjarizim i ekuipazheve ajrore shqiptare me Gardën Kombëtare të New Jersey

Kanë përfunduar më 2 gusht 2021, trajnimin dyjavor 5 pilotët e Forcës Ajrore për familjarizimin e ekuipazheve ajrore shqiptare me ato të Gardës Kombëtare të New Jersey të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Ky është ndërveprimi i dytë me ekuipazhet ajrore që kryejnë fluturime në tokën amerikane me Gardën Kombëtare të New Jersey, me qëllim rritjen e kapacitetit operacional ajror të ekuipazheve, standardizimin e procedurave dhe ndërveprimin e ekuipazheve ajrore shqiptare me ato të Gardës Kombëtare të New Jersey dhe Ushtrisë Amerikane si dhe ruajtjen e rritjen e aftësive operationale duke përdorur pajisje të ndryshme speciale të aviacionit.

Trajnime të tilla në kuadër të programeve të bashkëpunimit me Zyrën Amerikane të Bashkëpunimit të Mbrojtjes (ODC), janë kryer edhe në vitin 2019.

Bashkëpunimi me Gardën Kom-



bëtare të Aviacionit të New Jersey, të Ushtrisë Amerikane (New Jersey Army Aviation National Guard) do të jetë i vazhdueshëm për helikopterët EC145 si dhe për ekuipazhet ajrore që do të fluturojnë me helikopterët Black Hawk duke synuar rritjen e

kapaciteteve operationale të ekuipazheve ajrore shqiptare në gjithë spektrin e operationeve ajrore me helikopter, ditën, natën dhe me instrumente në misione ushtarake dhe në mbështetje të emergjencave civile.

“Pilotë shqiptarë nga Forcat e Armatosura të Shqipërisë ndodhen në SHBA si pjesë e një bashkëpunimi të gjatë midis Forcave të Armatosura Shqiptare dhe Gardës Kombëtare të New Jersey.”

Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë publikoi në rubrikën e saj “Foto e ditës”, disa foto nga takimi që gjeneralbrigade, Lisa J. Hou, ndihmësgjenerale e New Jersey, zhvilloi me pilotët nga Forcat e Armatosura të Shqipërisë, ndërsa mban në dorë një portret të gdhendur me shqiponjën shqiptare dhe heroin kombëtar, Skënderbeun.

Ambasada bën të ditur se, pilotët shqiptarë morën pjesë në fluturime për t'u familjarizuar me helikopterët UH-72 Lakota të Gardës Kombëtare të New Jersey, si pjesë e një bashkëpunimi të gjatë midis Forcave të Armatosura Shqiptare dhe Gardës Kombëtare të New Jersey.

Bashkëpunim midis FA dhe Gardës Kombëtare të New Jersey





Udhëtim ndër vite me Kozma Dushin

Mësuesi i kantos ndan me ne rrugëtimin e tij në muzikë dhe punën 16 vjeçare në QKMBMMFA

INTERVISTOI: HAJRIE DEDAJ

Kozma Dushi është një personazh mjaftë interesant në fushën e muzikës, prej vitesh nëpërmjet zërit të tij ai i ka dhënë jetë shumë këngëve. Me një karrierë mbi 45 vjeçare ai ka qenë pjesëmarrës në shumë aktivitete, festivale apo koncerte. Numëron me dhjetëra çmime në karrierë, por për të vlerësimi më i madh është respekti, që sheh në sytë e njerëzve sa herë që e përshëndesin. 'Kjo gjë është dhe triumfi im më i madh' - shprehet ai. Fillimet e tij i pati në vendlindje, në qytetin e Beratit. Artisti përfundoi studimet e shkollës së mesme për zooteknik, pasi kishte një pasion mjaftë të madh për kafshët, por me këmbënguljen e vëllait më vonë vijoi studimet në Institutin e Lartë të Arteve. Përfundoi studimet e larta në vitet 1980-1984, më pas karrierën e tij e shoqëruan një sërë aktiviteteve artistike në të cilat ai formoi muzikantin që është sot. Prej 2005 ai jep mësim kantoje pranë Qendrës së Kulturës së Ministrisë së Mbrojtjes. Më poshtë do të gjeni më shumë detaje nga intervista e zhvilluar me mësuesin e kantos në QKMBMMFA...

Ju keni mbi 45 vite në skenë, si e kujtoni daljen tuaj të parë, po këngën e parë që keni kënduar. Cila ka qenë ajo?

Në përgjithësi jeta artistike fillon në fëmijëri, unë fillimet e mia i kam pasur në moshën 12 vjeçare 1965-1966. Këngën e kam pasur pasion që në shkollë. Profesori i muzikës në shkollën "Thimi Tane" ishte ai që më zbuloi, profesor Bardhyl Ruzi i cili ishte instrumentist në estradën e Beratit, i binte trombës dhe firzamonikës. Në shkollë kur këndonim në korr dëgjoji zërin tim dhe më thotë se duhet të shkoja në Pallatin e Pioneerëve. Ishte pikërisht mësuesi i muzikës i cili u interesua për mua, ai bisedoi me personat e duhur në Pallatin e Pioneerëve me profesor Asqeri Kadena, një mësues i cili i donte dhe i ndihmonte fëmijët. Kënga ime e parë ka qenë për kalldrëmet e Beratit ishte një periudhë që po rregulloheshin. "Çekiçi dhe dalta" ishte kënga, që kam kënduar në festivalin e fëmijëve me muzikë të Luan Sadushit një kompozitor shumë i mirë. Më vonë në moshën 17 vjeçare kam marrë pjesë në estradën profesioniste të qytetit tim.

Festivali i 15-të i vitit 1976 në

Radio Televizionin Shqiptarë është fillimi i rrugëtimit tuaj, sa ndryshoi karriera juaj muzikore prej atij momenti ?

Në 31 korrik 2006, ISAF i drejtuar nga NATO merr komandën e rajonit jugor të Afganistanit nga forcat e koalicionit të udhëhequr nga SHBA, duke zgjeruar zonën e saj të operacioneve për të mbuluar edhe gjashtë provinca të tjera-Daikundi, Helmand, Kandahar, Nimroz, Uruzgan dhe Zabul-dhe duke marrë përsipër komandimi i katër PRT shtesë. ISAF i zgjeruar tashmë drejtonte gjithsej 13 PRT në veri, perëndim dhe jug, duke mbuluar rreth tre të katërtat e territorit të Afganistanit. Në 5 tetor 2006, ISAF zbaton fazën përfundimtare të zgjerimit të tij, duke marrë komandën e forcave ushtarake ndërkombëtare në Afganistanin lindor nga koalicioni i udhëhequr nga SHBA. Përveç kësaj, ISAF fillon të vendosë ekipe trajnimi dhe mentorimi në njësitë e Ushtrisë Kombëtare Afgane në nivele të ndryshme komandimi. Në 28-29 nëntor 2006, në Samitin e Rigës, udhëheqësit e NATO-s bien dakord të heqin disa nga vërejtjet dhe kufizimet kombëtare se si, kur dhe ku mund të përdoren forcat e tyre. Në 3 prill 2008, në Samitin e Bukureshtit, vendet që kontribuan me trupat ISAF përcaktuan një vizion strategjik për Afganistanin, i udhëhequr nga katër parime: një angazhim afatgjatë i vendosur dhe i përbashkët; mbështetje për udhëheqje dhe përgjegjësi të shtuar afgane; një qasje gjithëpërfshirëse nga bashkësia ndërkombëtare, duke bashkuar përpjekjet civile dhe ushtarake; dhe rritjen e bashkëpunimit dhe angazhimit me fqinjët e Afganistanit, veçanërisht Pakistanin. Në gusht 2008, përgjegjësia kryesore e sigurisë për qytetin Kabul u transferohet forcave afgane dhe në 17 shkurt 2009, Presidenti i ri amerikan Barak Obama njofton një shtesë prej 17,000 trupash që do të vendosen në Afganistan gjatë pranverës dhe verës për të kundërshtuar talebanët e ringjallur dhe për të ndaluar rrjedhën e luftëtarëve të

huaj në jug të Afganistanit. Në 27 mars 2009, presidenti Obama shpall një strategji të re për Afganistanin dhe Pakistanin. Ai gjithashtu merr vendimet të vendosë 4,000 trupa në Afganistan si trajnerë për forcat afgane të sigurisë dhe 3-4 prill 2009, në Samitin e Strasburgut/Kehl, udhëheqësit aleatë bien dakord të dërgojnë 5,000 trupa shtesë për të trajnuar forcat afgane të sigurisë dhe për të siguruar sigurinë për zgjedhjet presidenciale në gusht.

Shtator 2009- shkurt 2011, Konternimi i Sigurimit: Më shumë çizme në terren

Në 21 nëntor 2009, pas vendimeve të marra në Samitin e Strasburgut/Kehl në Prill 2009, Misioni Trajnues i NATO -s në Afganistan aktivizohet zyrtarisht. Qëllimi i tij është të sjellë së bashku përpjekjet për të trajnuar forcat afgane. Në dhjetor 2009, pas një rishikimi tremujor të fushatës ushtarake, Presidenti Obama vendos për një rritje të trupave që përfshin vendosjen e 30.000 trupave të tjerë, ndërsa premtoi gjithashtu se do të fillojë tërheqjen e trupave amerikane deri në verën e vitit 2011. Ministrat e Jashtëm të NATO-s njoftojnë vendosjen e edhe 7000 ushtarë të tjerë. Kurse në 28 janar 2010, në një konferencë ndërkombëtare në Londër, përfaqësues të nivelit të lartë nga mbi 70 vende diskutojnë planet për të dorëzuar gradualisht drejtimin e operacioneve të sigurisë forcave afgane të sigurisë. Në 20 korrik 2010, Bordi i Përbashkët Afgano-NATO Integal u krijua si mekanizëm për të vlerësuar gatishmërinë e rretheve dhe provincave për të kaluar në drejtimin afgan për siguri. Ndërsa në 20 korrik 2010, në një konferencë në Kabul, të organizuar nga qeveria afgane dhe bashkë-kryesuar nga Kombet e Bashkuara, qeveria bëri një angazhim të ripërtërirë ndaj popullit afgan, duke paraqitur një plan të udhëhequr nga afganët për përmirësimin e zhvillimit, qeverisjes dhe sigurisë. Në 19-20 nëntor 2010, në Samitin e Lisbonës, udhëheqësit e NATO-s bien dakord me qeverinë afgane për të dorëzuar përgjegjësinë e plotë për sigurinë në Afganistan nga ISAF te

forcat afgane deri në fund të vitit 2014. Kalimi gradual në drejtimin e sigurisë afgane u vendos të nisë në 2011, duke filluar në zona që relativisht të qëndrueshme. NATO dhe Afganistani gjithashtu nënshkruan një deklaratë mbi Partneritetin e Qëndrueshëm, duke siguruar një kornizë për mbështetje afatgjatë politike dhe praktike, e krijuar për të vazhduar edhe pas misionit ISAF.

Mars 2011 – dhjetor 2014: Kalimi drejt udhëheqjes afgane për siguri

Në 22 mars 2011, Presidenti Karzai shpall grupin e parë të provincave dhe rrethëve afgane që fillojnë të kalojnë drejt udhëheqjes afgane për siguri. Ndërkohë në 1 maj 2011, Osama Bin Laden vritet nga forcat e operacioneve speciale amerikane në Pakistan dhe në 22 qershor 2011, Presidenti Obama shpalli planet për të tërhequr 10,000 trupa deri në fund të vitit dhe 20,000 të mbetur të trupave "të rritur" deri në verën e vitit 2012. Në 26 nëntor 2011, zyrtarët pakistanezë pohojnë se avionët e NATO -s vranë të paktën 25 ushtarë në sulmet kundër dy posteve ushtarake në kufirin veriperëndimor me Afganistanin dhe NATO filloin një hetim i cili më vonë zbuloi se koordinimi i dobët dhe gabimet e bëra nga forcat e NATO-s dhe ato pakistaneze shkaktuan incidentin. Në 5 dhjetor 2011, një konferencë ndërkombëtare zhvillohet në Bon, për të diskutuar bashkëpunimin me Afganistanin për tërheqjes së ISAF në fund të vitit 2014. Presidenti afgan angazhohet për forcimin e luftës kundër korrupsionit në këmbim të ndihmës së vazhdueshme zhvillimore ndërkombëtare. Pakistani bojkoton konferencën për shkak të vdekjeve të shkaktuara nga sulmet ajrore të NATO -s në nëntor dhe në 1 prill 2012, Qendra Rajonale e Trajnimit të Policisë në Mazar-e Sharif iu dorëzohet afganëve që më vonë bëhet një vend trajnimi për Policinë Kombëtare Afgane të Rendit Civil.

Në 21 maj 2012, në Samitin e Çikagos, udhëheqësit nga 28 vendet anëtare të NATO-s dhe 22 partnerët në koalicionin ISAF i dhanë Afganistanit një angazhim të qartë dhe afat-

gjatë për të vazhduar mbështetjen e forcave afgane të sigurisë me trajnime, këshilla dhe ndihmë pas udhëheqjes së NATO-s dhe Misioni ISAF ka përfunduar në vitin 2014. Mbi 4 miliardë dollarë u premtuan për të mbështetur forcat afgane. Në 8 korrik 2012, në konferencën e donatorëve në Tokio për Afganistanin, bashkësia ndërkombëtare premtoi 16 miliardë dollarë ndihmë zhvillimore deri në vitin 2015 përtej tërheqjes së ISAF. Por presioni i bëhet qeverisë për të mbajtur zgjedhje gjithëpërfshirëse, transparente dhe të besueshme; për të luftuar korrupsionin dhe për të përmirësuar qeverisjen e mirë; të respektojë kushtetutën, veçanërisht të drejtat e njeriut; dhe për të zbatuar sundimin e ligjit. Në 16 korrik 2012 ngrihet Komanda e Operacioneve Speciale të Ushtrisë



Afgane. Kurse në 1 shkurt 2013, Komanda e Forcave Tokësore Afgane krijohet për të mbikëqyrur të gjitha operacionet në Afganistan, ndërsa në 1 prill 2013, krijohet : Universiteti Kombëtar Afghan i Mbrojtjes, për të trajnuar oficerët e ardhshëm të Ushtrisë Kombëtare Afgane. Në 24 nëntor 2013, Loya Jirga voton në favor të një Marrëveshjeje Dypalëshe të Sigurisë me Shtetet e Bashkuara, duke i bërë thirrje Presidentit Hamid Karzai të nënshkruajë marrëveshjen menjëherë. Marrëveshja rregullon pranimin e trupave amerikane në Afganistan pas vitit 2014 dhe është e nevojshme për të mundësuar që mijëra ushtarë amerikanë të qëndrojnë në Afganistan pas tërheqjes së ISAF. Në shtator 2014, në Samitin e NATO-s në Uells, udhëheqësit e vendeve që kontribuojnë në trupat ISAF nënvizojnë angazhimin e tyre për të vazhduar mbështetjen e Afganistanit pas vitit 2014. Në 30 shtator 2014 daton

një marrëveshje për statusin e forcave midis NATO -s dhe Afganistanit që nënshkruhet në Kabul. I ratifikuar nga Parlamenti Afganistan në nëntor, ajo siguron kuadrin ligjor për një mision të ri jo-luftarak të udhëhequr nga NATO ("Mbështetje e Vendosur") për të trajnuar, këshilluar dhe ndihmuar forcat dhe institucionet afgane të sigurisë, duke filluar në Janar 2015. Në 12 dhjetor 2014, Këshilli i Sigurimit i OKB -së miraton njëzëri Rezolutën 2189, duke mirëpritur Misionin e ri Mbështetës të vendosur. Në 28 dhjetor 2014, në një ceremoni në Kabul, ISAF përfundon zyrtarisht misionin e tij në Afganistan, duke përfunduar një proces tranzicioni trevjeçar, ku udhëheqja për sigurinë gradualisht u transferohej afganëve. Forcat afgane të sigurisë tani kanë përgjegjësinë e plotë të sigurisë

për Afganistanin.

Janar 2015: Trajnimi, Ndihma dhe Këshillimi i Institucioneve të Sigurisë Afgane

Në 1 janar 2015, Misioni Mbështetës i Vendosur (RSM) fillon të vazhdojë të ofrojë trajnim, këshilla dhe ndihmë për Forcat Kombëtare Afgane të Mbrojtjes dhe Sigurisë (ANDSF) dhe në 13 maj 2015, ministri i Jashtëm të NATO-s vendosin që Aleanca do të mbajë një prani të udhëhequr nga civilët në Afganistan pas përfundimit të RSM me qëllim që të vazhdojë të këshillojë dhe udhëzojë institucionet afgane të sigurisë, për t'i ndihmuar ata të bëhen të vetë-mjaftueshëm. Në 15 tetor 2015, Sekretari i Përgjithshëm i NATO -s mirëpret njoftimin e Presidentit Obama se Shtetet e Bashkuara do të ruajnë nivelet e tanishme të

trupave të tyre në Afganistan deri në vitin 2016 dhe do të mbajnë një prani të konsiderueshme përtej vitit 2016. Në 1 dhjetor 2015, ministrat e Jashtëm të NATO -s dhe partnerët e tyre RSM bien dakord për një plan për të mbështetur misionin e trajnimit në Afganistan gjatë vitit 2016 dhe të fillojnë punën për të siguruar financim për forcat dhe institucionet afgane të sigurisë deri në fund të vitit 2020.

Në 9 korrik 2016, në Samitin e NATO -s në Varshavë, udhëheqësit aleatë dhe partnerët e tyre RSM pranojnë se, ndërsa institucionet dhe forcat afgane të sigurisë vazhdojnë të zhvillohen dhe bëjnë përparim, sfidat dhe boshllëqet e aftësive vazhdojnë dhe ata vazhdojnë të kenë nevojë për mbështetje ndërkombëtare. Ata riafirmojnë angazhimin e tyre të ndërsjellë për të siguruar siguri dhe stabilitet afatgjatë në Afganistan duke mbështetur RSM përtej vitit 2016; mbështetje e vazhdueshme financiare për Forcat Afgane të Mbrojtjes dhe Sigurisë deri në fund të vitit 2020; dhe forcimin e Partneritetit të Qëndrueshëm midis Afganistanit dhe NATO -s. Në 5 tetor 2016, 75 vende dhe 26 organizata dhe agjenci ndërkombëtare premtuan 15.2 miliardë dollarë në mbështetje financiare për Afganistanin deri në vitin 2020. Në 9 nëntor 2017, ministrat e Mbrojtjes nga aleatët e NATO -s dhe vendet partnere bien dakord të rrisin kontributet e tyre të trupave në RSM në muajt e ardhshëm nga rreth 13,000 në rreth 16,000 trupa. Ministri gjithashtu konfirmojnë se ata do të vazhdojnë të financojnë forcat afgane të sigurisë deri të paktën në vitin 2020. Në 27 prill 2018, ministrat e Jashtëm të NATO-s riafirmojnë angazhimin e NATO-s për zhvillimin e forcave afgane të sigurisë dhe mbrojtjes përmes një qasjeje të bazuar në kushte për Misionin e Mbështetjes Vendosëse. Ata shprehin mbështetje për propozimin e presidentit afgan për bisedime paqeje midis Qeverisë së Unitetit Kombëtar dhe Talibanëve në një proces të udhëhequr nga Afganistani dhe në pronësi të Afganistanit. Ata gjithashtu "nënvizojnë rëndësinë e zgjedhjeve të drejta, gjithëpërfshirëse dhe në kohë parlamentare dhe presidenciale që do të mbahen në 2018 dhe 2019". Në 8 qershor 2018, ministrat

e Mbrojtjes nga aleatët e NATO -s dhe vendet partnere diskutojnë forcimin e mbështetjes së RSM për qeverinë afgane dhe forcat afgane të sigurisë dhe në 12 korrik 2018, krerët e shteteve dhe qeverive të aleatëve dhe partnerët që kontribuojnë me trupat RSM takohen me presidentin afgan në Samitin e Brukselit. Ata mirëpresin përparimin që po bëjnë institucionet afgane të sigurisë si rezultat i përpjekjeve të RSM-së për ngritjen e kapaciteteve dhe reformave institucionale të udhëhequra nga Afganistani. Ata nënvizojnë se forcat afgane efektive, profesionale dhe të qëndrueshme do të jenë më të afta të sigurojnë siguri për vendin, të krijojnë kushte për një zgjidhje të negociuar të konfliktit përmes një procesi paqësor të udhëhequr nga Afganistani dhe në pronësi të Afganistanit dhe t'u demonstrojnë talebanëve se nuk mund të mbizotërojnë me forcë. Ata mirëpresin ofertën e pashembullt të qeverisë afgane për bisedime pa kushte të paqes ndaj talebanëve dhe u bënë thirrje talebanëve të angazhohen në mënyrë të besueshme në këtë proces. Aleatët dhe partnerët përsëritën rëndësinë e qeverisjes së mirë dhe gjithëpërfshirëse, ndërtimin e institucioneve si dhe zhvillimin social dhe ekonomik, i cili do të ndihmonte në vendosjen e kushteve për stabilitet afatgjatë dhe do të kishte një ndikim të rëndësishëm në migrim. Qeveria afgane mori një numër angazhimesh në këtë drejtim. Në 29 shkurt 2020, Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg merr pjesë në një ceremoni të mbajtur në Pallatin e Presidentit me Presidentin afgan Ashraf Ghani së bashku me Sekretarin Amerikan të Mbrojtjes Mark Esper, për të shënuar Deklaratën e Përbashkët mes Shteteve të Bashkuara dhe Republikës Islamike të Afganistanit dhe nënshkrimin të një marrëveshjeje midis Shtetet e Bashkuara dhe talebanëve. Këshilli i Atlantikut të Veriut mirëpreti këto hapa të parë të rëndësishëm në ndjekje të një zgjidhjeje paqësore dhe merr përsipër të zbatojë rregullime të bazuara në kushte, duke përfshirë një reduktim të pranisë ushtarake. Në 24 prill 2020, Këshilli i Atlantikut të Veriut reflekton se perspektiva e fillimit të negociatave për të arritur një marrëveshje gjithëpërfshirëse

të paqes në Afganistan paraqet një mundësi historike për t'i dhënë fund konfliktit dhjetëvjeçar. Aleatët u bënë thirrje urgjentisht udhëheqësve politikë të Afganistanit dhe mbështetësve të tyre që të mblidhen së bashku për të zgjidhur mosmarrëveshjet e tyre dhe për të formuar një qeveri gjithëpërfshirëse, ndërkohë që u bëjnë thirrje talibanëve që të zvogëlojnë dhunën dhe të krijojnë kushte të favorshme për fillimin e negociatave. Në 14 korrik 2020, Këshilli i Atlantikut të Veriut u bënë thirrje të gjitha palëve që të zgjidhin me shpejtësi çështjet e mbetura që ende përjashtojnë fillimin e negociatave gjithëpërfshirëse brenda Afganistanit dhe pasqyron se nivelet e dhunës, të nxitura veçanërisht nga sulmet e talebanëve ndaj forcave të sigurisë afgane, mbeten të papranueshme të larta. Në 12 shtator 2020, aleatët e NATO-s mirëpresin fillimin e negociatave të paqes brenda Afganistanit, të shpallura në një ceremoni në Doha. Ata i bënë thirrje qeverisë afgane dhe talebanëve që të përmbushin angazhimet e tyre për të punuar drejt një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse paqeje. Në 14 prill 2021, aleatët vendosin të fillojnë tërheqjen e forcave RSM deri më 1 maj dhe ta përfundojnë atë brenda pak muajsh. Në 14 qershor 2021, në Samitin e Brukselit, Udhëheqësit Aleatë rikonfirmuan vendimin për të tërhequr praninë ushtarake, duke mbetur të përkushtuar për të ofruar trajnim dhe mbështetje financiare për forcat dhe institucionet afgane të sigurisë, dhe mbajtjen e Zyrës së Përfaqësuesit të Lartë Civil në Kabul për të vazhduar angazhimin diplomatik me Afganistan. Ata gjithashtu u angazhuan për të siguruar funksionimin e vazhdueshëm të Aeroportit Ndërkombëtar Hamid Karzai për të ruajtur lidhjen e Afganistanit me pjesën tjetër të botës. Aleatët gjithashtu përsëritën mbështetjen e tyre për procesin e paqes në pronësi afgane dhe të udhëhequr nga afganët. Dhe në gusht 2021, pas rënies së qeverisë afgane dhe Forcave Afgane të Mbrojtjes dhe Sigurisë, NATO u fokusua në sigurimin e largimit të sigurt të personelit nga vendet aleate dhe partnere, dhe të afganëve që kanë ndihmuar në angazhimin e NATO -s.

“Ti Shqipëri më jep nder!”

Rilindasi Naim Frashëri nguliti tek shqiptarët dashurinë për Atdheun



Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

Dashuria për Atdheun ndjenjë e shëndetëshme

Rilindasit e mëdhenj theksonin se dashuria për Atdheun është një ndjenjë e shëndetëshme natyrale, e cila me pak përkujdesje kultivohet lehtë. Kurse prirja e kundërt, mosdashuria për të është rrjedhojë e disa faktorëve këmbëngulës. Injoranca e thellë ku u zhyt për shumë shekuj populli ynë, mungesa e shkollave, e universiteteve, e akademive, pra e të gjitha institucioneve kulturore, e natyrisht mungesa e strukturave shtetërore, e zbehu fort shqiptarizmin ose, në rastin më të mirë e la atë në një nivel primitiv, që me vështirësi e kapërcente folklorizmin. Në kushte të tilla, ku përballja me një kulturë të huaj ishte tronditëse për shqiptarët. Ajo krijonte dy rrjedhime: ose i shtynte ata, që në shembëllimin e kësaj kulture të ringjallnin kulturën e vendit të vet, ose e kundërta, i largonte përfundimisht prej Atdheut. Kështu, në prag të çlirimit të Shqipërisë i kemi patur të dyja prirje: atdhedashurinë e disave dhe shqiptarizmin, e kundërshqiptarizmin e disa të tjerëve.

Ndërsa Naimi shfaqet nga sheshi i purpurt i Qerbelasë, i sakrificës titanike dhe konceptuale në shekuj, duke i rënë xhurasë, mes trimërive stërgjyshore, që kumbojnë rreth e qark”, - ka theksuar Moikom Zeqo.

Natyra unike e gjuhës shqipe përbënte një bazë për mitin kombëtar. Periudha e Skënderbeut 1443-1468, përfaqëson të parën shprehje të nacionalizmit shqiptar, i cili u venit pas pushtimit osman dhe u ringjall sërish më 1878, pas Kongesit të Berlinit që vendosi lënien e disa trojeve shqiptare jashtë Perandorisë Otomane për esap të Malit të Zi, Serbisë dhe Bullgarisë.

Shek. XIX shënoi konsolidimin e mendimit nationalist shqiptar, nëpërmjet asaj që u quajt periudha e Rilindjes Kombëtare. Shkrimtar i madh shqiptar, një nga përfaqësuesit më të shquar të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, poeti i madh Naim Frashëri u gjend në vendin e duhur. Në atë kohë Shqipëria ishte e ndarë në katër vilajete: i Kosovës, i Shkodrës, i Manastirit dhe i Janinës. Shoqëria shqiptare ishte e ndarë në dy grupime kulturore: gegët dhe toskët. Në Shqipëri po bashkëjetonin katër besime fetare: myslimanë, bektashinj, ortodoksë dhe katolikë. Kjo tolerancë e gjerë e popullit e shoqëruar me tolerancën fetare, të vërtetuar gjatë shekujve, nuk u vu në dukje e nuk u çmua asnjëherë sa duhet. Ishte e nevojshme, për të mos thënë e detyrueshme të çmohej. Kishim të bënim me një shembull të shkëlqyer ballkanik, në kohën që gadishulli i madh u

përfshi tej e mbanë nga furtunat shoviniste, nga intoleranca e urrejtja etnike e nga krimet e rënda të ushqyera prej saj. Duhet thënë se kjo nuk ishte një dukuri e rrallë. Në shumicën e vendeve, ashtu siç ka një përqindje të popullsisë me prirje kriminale, ka edhe një përqindje me prirje të mbrapshtë (perverse) kundër Atdheut të vet. Kjo është e njohur që nga kohërat antike, kur midis grekëve të vjetër gjendeshin gjithmonë njerëz e prijesa që bashkoheshin me armiqtë e Greqisë, e deri në kohën tonë, ku grupimet e ndryshme politike, sidomos ato ekstremiste, terroriste, maoiste etj., cilësi e parë e të cilëve është urrejtja kundër vendit të tyre dhe bashkimi me çdo forcë tjetër që është kundërshtar i tij. Ky ka qenë dhe shqetësimi i rilindasve lidhur me këtë hall të madh tregon se prirja kundërshqiptare e një pjesë të shqiptarëve ka qenë një rrezik i ndjeshëm për Shqipërinë. Një prirje e mbrapshtë nuk mund të mbetet gjallë për një kohë të gjatë, pa u ushqyer. Kështu Naim Frashëri u bë dhe edukatori kombëtar.

Fatkeqësitë e kaluara të popullit shqiptar, pushtimi osman në shek. XV, copëtimi i Shqipërisë në fillim të shek. XX dhe izolimi i saj nga bota për faj të diktaturës komuniste në gjysmën e dytë të shek. XX nuk krijuan tek shqiptarët as doktrina shfarosëse, as urrejtje kundër të tjerëve dhe kjo është një cilësi e admirueshme e tij. Nderimi dhe mbrojtja e tjetrit, i atij që është i ardhur, i huaj, mik ose bujtës, një mendësi

që vjen qysh nga kohët antike, ka qenë një ndër gurët themelore të qytetërimit shqiptar. Që ky nderim nuk është shpikje poetësh, e as një cilësi e elitës shqiptare, u vërtetua gjatë Luftës së Dytë Botërore. Dhjetra mijra italianë të mbetur në Shqipëri në mëshirën e popullsisë së armatosur shqiptare, pas kapitullimit të Italisë, nuk u prekën aspak prej kësaj popullsie, përkundrazi u morën nën mbrojtje prej saj. Nga ana tjetër, është fakt i njohur tashmë që Shqipëria ishte një nga vendet e rralla në botë, në mos i vetmi, që nuk dorëzoi asnjë hebre tek nazistët. Monizmi me politikën e tij veçuese u mundua ta armiqësonte popullin shqiptar me gjithë botën, kryesisht me botën perëndimore, por nuk ia doli dot. Pas rënies së komunizmit, populli shqiptar dëshmoi ndaj të huajve europianë dhe amerikanë po atë ndjenjë miqësore të dikurshme.

Rizgimi i Atdhedashurisë


Rilindasi Naim Frashëri dhe të gjithë rilindasit e tjerë duhet lexuar e rilexuar gjithmonë, sidomos në kohëra të vështira. Duke i shfletuar tani, shikojmë se përveç shqetësimit të tyre themelor: çlirimit të Shqipërisë dhe pavarësisë së saj, ishte një anktë tjetër, i vazhdueshëm, i lidhur ngushtë me të parin: rizgimin e Atdhedashurisë. Lidhja e Prizrenit, e cila pasoi Kongresin e Berlinit, shënon përpjekjen e parë për institucionalizimin e nacionalizmit dhe njëkohësisht të kombit shqiptar. Kërkesat e saj ishin bashkimi i trojeve shqiptare në një territor të vetëm me autonomi të plotë nën Perandorinë Osmane. Kështu lindi nocioni i Shqipërisë Etnike, ku për herë të parë shqiptarët do të shprehnin aspiratat e tyre kombëtare. Këmbëngulja e tyre për këtë rizgim, thirrjet e zjarrta "Ti Shqipëri më jep nder, më jep emrin shqiptar" dëshmojnë një të vërtetë tepër të qartë dhe dëshpëruese. Një pjesë e shqiptarëve ishin ftohur prej Atdheut të tyre. Turqizimi i qindramijëra shqiptarëve, greqizimi i një pjesë tjetër, ngatërrimi i përkatësisë shqiptare me atë fetare, dëshmojnë se ndjenja patriotike e

një pjesë të shqiptarëve ka qenë jo aq e fortë siç paraqitej. Një pjesë e tyre me lehtësi ishin gati ta këmbenin Atdheun e tyre me një Atdhe tjetër, një pjesë kishin turp të quheshin shqiptarë, të tjerë me lehtësi viheshin në shërbim të forcave kundërshqiptare.

Nga pena e Naimit doli më

Rifitimi të besimit të humbur

Rilindasit e himnizuan dhe e sublimuan historinë e shqiptarëve që lëvizja dhe ky vrull të ishin të suksesshëm. Ata qëmtuan në kulmet e ndritura, duke mos ndalur në njollat e saj. Po me kaq këmbëngulje ata



1886 "Bagëti dhe Bujqësia", e para poemë letrare shqipe që ngjallte tek bashkatdhetarët e vet vërtetësinë e prejardhjes së tyre gjuhësore kombëtare dhe krenarinë nacionale. Kështu Rilindasit u përpoqën shumë ti bindnin shqiptarët se nuk duhet të turpëroheshin nga vendi i tyre. Ata kishin një Atdhe të bukur, kishin një gjuhë madhështore, një prej 6 gjuhëve themelore të Europës dhe një nga 10-12 gjuhët themelore të Botës. Ata ishin racë e bukur trupërisht dhe tepër të aftë mendërisht, se kishin një histori të shkëlqyer, se gjëmat kombëtare nuk ishin një arsye për t'u ftohur me Atdheun, por përkundrazi, për t'u afruar më fort me të. Aksioni i tyre për zgjimin e Shqipërisë ishte më i madh dhe më i gjëri aksion kulturor në krejt historinë tonë shqiptare. Rrallë herë emërtimi i një lëvizje përkonte plotësisht me qëllimin e saj, ashtu si në rastin e Rilindjes Shqiptare. Në të vërtetë ishte ajo që Rilindi Shqipërinë, ose me saktë, ishte ajo që lindi Shqipërinë moderne.

vunë në pah vlerat morale e fizike të shqiptarëve, kryesisht virtytet pa dashur të ndalen në cenet e tyre, që për hir të vërtetës, nuk ishin më të pakta se virtytet. Kjo ishte rrjedhojë llogjike e qëllimit të lëvizjes: rifitimit të besimit të humbur. Një arsye tjetër që e përlligjte vizionin e tyre pozitiv ishte propaganda kundërshqiptare, që kishte nisur ndërkaq të kultivohej nga fqinjët e Shqipërisë: kryesisht nga rrethet shoviniste serbe dhe greke. Ishte një propagandë e egër dhe shtazarake që rrallë herë ishte parë në fytyrën e dheut. Përballë kësaj furtune të sëmurë, rilindasit shqiptarë mbajtën një qëndrim fisnik e të admirueshëm. Në vend që të binin në nivelin e saj, duke u përdhosur dhe vetë nga balta e kundërshtarëve, ata zgjodhën përgjigjen e tërthortë: lartësimin e vlerave shqiptare. Ky vizion optimist i rilindasve, i përfaqësuar në radhë të parë prej Naim Frashërit e me vonë prej at Gjergj Fishtës, u bë objekt vërejtjesh e kritikash më pas e vazhdon ende sot, në mënyrë



të drejtpërdrejtë apo të tërthortë.

Naim Frashëri, mori nismën e pabesueshme dot për të krijuar një mistikë familjare dhe shpirtërore për shqiptarët e tij, pra bektashizmin tipologjik dhe përbashkues gjithëshqiptar. Ringritja morale e popullit shqiptar ishte aksioni më i ngutshëm dhe më i rëndësishëm në atë kohë të vështirë që ndërmnorën rilindasit. Ai ishte çelësi, pa të cilin nuk mund të ndërmerret asnjë veprim tjetër shpëtues. A ishin shqiptarët patriotë më shumë se ç'duhet, apo përkundrazi ishin ftohur me vendin e vet? A mos po e mbiçmonin pa të drejtë veten dhe vendin e tyre, a mos përkundrazi e përçmonin pa të drejtë veten dhe Atdheun. Me fjalë të tjera: a e donin këtë vend që u ka dhënë emrin qysh prej dymijë vjetësh, apo ëndërronin ta këmbenin me një tjetër vend. Ëndërr e mbrapshtë kjo që ka ngritur krye aty-këtu e herë pas herë në kohën tonë? E pra në këtë mijëvjeçar të tretë shqiptarët janë të detyruar të nxjerrin ende mësim nga drama e tyre, që ndodhet ende në zhvillim.

Në kushtet e një klime të ashpër ndërkombëtare, kur populli shqiptar, i vetmi komb i ndarë tragjikisht në Europë është i detyruar të durojë mospërfilljen botërore për fatkeqësinë që i ka rënë në kokë. Në kushtet e vetmisë së tyre, të trysnisë së një propagande deri tani dashakeq

që ka përbaltur imazhin tonë në botë. Duke na paraqitur herë si një popull violent, herë fundamentalist, herë barbar e herë të lajthitur, shqiptarët janë detyruar, midis të tjerash, të bëjnë një zgjedhje e sqarim themelor në ndërgjegjen e tyre lidhur me patriotizmin. Mendimit të mbrapshtë që e ngatërron patriotizmin si balsam kundër nacionalizmit, ata duhet ti përgjigjen me një "jo" të prerë. Patriotizmi nuk është nacionalizëm dhe antipatriotizmi është po aq i rrezikshëm sa shovinizmi.

Fyerjet morale janë të njohura tek jeta e popujve ashtu siç janë të njohura ringritjet. Por për tu ringritur çdo komb i duhet të tendoset fort e të nxjerrë nga brendësia e vet të gjitha rezervat që ka rezervuar, ato rezerva, që çdo popull, sipas një kodi të lashtë, i ruan për ditë të zeza e i përdorin në periudha fatkeqësish. Raportet me atdheun zënë në këtë rast një vend kryesor. Shqipëria s'ka nevojë për ekzaltime, por aq më pak s'ka nevojë për përçmim. Mendimi se Shqipëria dhe shqiptarët kanë qenë shumë të himnizuara nga kultura shqiptare, ndaj tani duhet ti rrezojmë në baltë për ti sjellë në vete, është doktrinë e antishqiptarizmit.

Kultura dhe mendimi i një populli qëndron gjithmonë në një

lashtësi të shquar e të lavdishme për ku përpiqet ta tërheqë e ta ngrëjë gjithë kombin. Në qoftë se populli shqiptar do të vazhdojë ta përçmojë e ta luftojë vetveten, në qoftë se ai në mënyrë irracionale do të synojë drejt shpërnguljes, nga trojet e shtetit shqiptar, në qoftë se ai do të vazhdojë të ngrëjë dorën kundër strukturave shtetërore të tij, të çfarëdo lloj ngjyre politike të jenë ato, ai do të eci drejt greminës. Imazhin e mirë ose të keq për një popull, nuk mund ta krijojnë për një kohë të gjatë as zyrtarët e tij, por as renegatet e tij; atë nuk mund ta krijojnë as nacionalistët e ekzaltuar, por as vulgu i egër dhe i verbër. Aq më pak mund ta krijojnë atë diplomatë mendjelehtë, gazetarët e pabesë, denoncuesit, psikopatët dhe paranjakët e dehur për lavdi.

Janë të gjitha gjasat që mijëvjeçari i tretë, pavarësisht nga tronditjet e Shqipërisë, të jetë i mbarë. I mbarë për ata që, ndonëse e quajnë veten bij të shqipes, gjer më sot nuk janë ngjitur dot kurrë në lartësinë e dëshiruar, veçse në ëndërrat e tyre. Ndonëse krahët disa herë u janë thyer, ende vazhdojnë ta quajnë veten si më parë, bij të shqipes. Këmbëngulje kjo që dëshmon, në fund të fundit, besnikëri ndaj asaj ëndërrë të moçme pafundësisht të ushqyer për vazhdimësi.

Raporti i zhdrejtë i fuqisë së “shpirtit” me “shpatën” në ushtrinë Afgane

Kolonel Hysni GJERGJI
Instituti i Kërkimit
Shkencor Ushtarak, AFA

Rënia e shpejtë e Afganistanit në duart e talebanëve, e ktheu këtë vend në pikën “zero” atje ku ndodhej para 20 vitesh, megjithëse perëndimi dhe veçanërisht SHBA shpenzuan triliarda dollarë për të ngritur, trajnuar dhe pajisur ushtrinë dhe forcat e sigurisë afgane, përsëri afganët “humbën luftën pa betejë”. Analistët e sigurisë përpiqen të shpjegojnë këtë “shkërmoqe” të ushtrisë afgane duke analizuar parimet dhe përvojën e luftërave në shekuj. Studiues ushtarakë, duke konsideruar raportin e forcave përballë (rreth 1 me 4) në favor të forcave të sigurisë afgane. Talebanët duke qenë në mësymje dhe ushtria afgane e pozicionuar në mbrojtje, vlerësohet të jetë e paprecedentë një humbje e tillë. Historia e luftërave nuk e njeh këtë rezultat të arritur në shekuj, pasi parimi i luftimit tradicional pranon të kundërtën e këtij raporti forcash. Po të shtojmë këtu armatimin dhe pajisjet në dispozicion të palëve, ku ushtria afgane ishte e pajisur me tanke dhe forcë ajrore, infrastrukturë mbrojtëse, fortifikime etj., ky raport është më i thellë.

Rezultati i humbjes së një ushtrie 4 herë më të madhe se sa kundërshtari, në operacion mbrojtës, bëhet akoma edhe më unik për t’u studiuar në historinë e luftërave dhe konflikteve botërore.

Why a bigger, better trained Afghan army was no match for Taliban



Por çfarë mungoi dhe nuk funksionoi tek forcat e sigurisë afgane? Analistët e sigurisë e gjejnë shpjegimin e këtij kapitullimi tek parimet e luftës, ndër të cilat përgatitja dhe gjendja moralo-psikologjike e trupave ushtarake në këtë përballje, mori rol kryesor. Çdo armë sado e fuqishme në duart e luftëtarëve pa motiv, pa zemër dhe që nuk duan të luftojnë, historikisht nuk ka pasur vlerë.

“Shpirti dhe shpata janë dy faktorët bazë të fuqisë së një ushtrie dhe raporti mes tyre duhet të jetë si 3 me 1 në favor të shpirtit” -na mëson Napolon Bonaparte. Në të vërtet

ky raport i “shpirtit me shpatën”, është në sens të kundërt tek përballja e talebanëve me ushtrinë afgane. Fuqia ushtarake e forcave të sigurisë afgane, rezultoi të jetë asgjë pa fuqinë e shpirtit të sakrificës, të ndjenjës së fitores dhe të vetëmohimit të ushtarëve të saj.

Mohammad Shafiq Hamdam, një ekspert i sigurisë në Afganistan thotë për Deutsche Vele se: “Ushtria afgane, të cilën unë e njoh shumë mirë, ishte e demoralizuar gjatë dhe para fillimit të tërheqjes së NATO-s, ndërsa e kundërta ndodhi tek talebanët të cilët qëndronin të motivuar gjatë gjithë

kohës dhe morën zemër pas fillimit të tërheqjes së NATO-s. Ushtria afgane mbeti një ushtri në letër, e pa provuar të qëndrojë mbi këmbët e veta, kur të mos mbështetej nga NATO. Mungesa e moralit, e besimit në fitore, e besimit tek lidhshipi, vlerësohen të jenë faktorët e rënies së sigurisë së Afganistanit”.

Megjithëse NATO dhe SHBA-të shpenzuan biliona për të trajnuar edhe pajisur ushtrinë afgane dhe policinë lokale, përsëri nuk rezultoi mjaftueshëm. U ngrit, u trajnuar dhe u pajis një ushtri me numër dhe pajisje luftarake të krahasueshme me vende të zhvilluara të NATO-s. SHBA-të dhanë gjithçka mund të jepnin pa kursim, por ata nuk mund të jepnin atë që është e brendshme, atë që nuk është e mundur të jepet, atë që ndodhet brenda qenies së secilit: “shpirtin luftarak”. Kjo nuk është e mundur të transferohet nga njëri tek tjetri nëpërmes faktorëve të jashtëm. Ky komponent i rëndësishëm i luftës mungoi tek trupat afgane pa moral të lartë luftarak, pa besim dhe pa dëshirë për të fituar këtë luftë.

“Fitimtarët e fitojnë luftën pastaj e fillojnë atë”, - na mëson Sun Tzu. Ushtria afgane nuk është ndjerë kurrë si fituese, ka qenë e pamotivuar, nuk ka funksionuar vetë, por gjithmonë parazite dhe e mbajtur në këmbë nga NATO dhe SHBA dhe ka hyrë në këtë luftë “e bindur në humbje”. E kundërta ka ndodhur me talebanët, -vlerësojnë ekspertët e sigurisë, -ata kanë luftuar pa ndërprerje me të gjitha metodat, politike dhe brutale, psikologjike dhe terroriste, fetare dhe mizore, duke mbetur kështu faktor edhe pas 20 vitesh nga dëbimi i tyre nga pushteti. Analistët e instituteve të sigurisë vlerësojnë se përveç mungesës së moralit edhe korrupsioni në sigurinë kombëtare afgane ishte shkak kryesor i kolapsit të saj. Korrupsioni vlerësohet të jetë tjetër faktor përcaktues në humbje, pasi në Ministrinë e Mbrojtjes ashtu edhe në ministrinë e brendshme ishte shumë i përhapur, ku fondet, armatimi, municioni dhe ushqimi i ushtarëve vidhej. Furnizimet, para se të shkonin tek ushtarët afganë shiteshin në tregun e zi dhe si rrjedhim shkonin edhe tek talebanët. Në këtë kontekst korrupsioni jo vetëm ka



dëmtuar moralin në ushtrinë afgane, por edhe ka ushqyer talebanët me para, ushqime dhe armatime.

Beteja “pa luftë” për të marrë Kabul, nuk ndeshi në kundërpërgjigje nga ana e forcave afgane, pasi shumica e trupave u dorëzuan, dezertuan, u shitën, u blenë apo iu bashkuan talebanëve. Ata nuk iu bashkuan një rezistence, pasi afganët e vlerësonin veten të pa shpresë për ta fituar këtë luftë dhe nuk kishin besim në lidhshpinin e tyre, i cili do të mund t’i çonte drejt fitores.

Integriteti i lidhshpinit drejtues politik dhe ushtarak është thelbësor për të fituar respektin, besimin dhe besnikërinë e trupave. Për ushtarët e papaguar, jeta e gënjeshtërt e drejtuesve nuk pranohej dhe nuk garantonte lidhshpinin të sigurt. Për këtë arsye, shumë ushtarë nuk preferuan të luftojnë, por të shpëtojnë jetën, t’i dorëzohen talebanëve ose të besojnë në një amnisti të premtuar. Përvetësimi dhe korrupsioni minoi dhe përçau lidhshpinin morale dhe kohezionin brenda hierarkisë ushtarake. Për më tepër disa drejtues ushtarakë jo vetëm vidhnin paratë e “ushtrisë fantazmë me rreth 100,000 vetë”, por edhe mbanin ushtarë të papaguar në detyrë, duke mos u dhënë as lejet për të shkuar në familjet e tyre për muaj me radhë. Ushtria afgane përveç sa më sipër, vitet e fundit, pati një numër gjithnjë në rritje të dezertimeve dhe dëmtimeve.

Disa OJQ dhe grupe studiuesish kanë raportuar në mënyrë të përsëritur për korrupsion në ushtrinë afgane dhe qeverinë e Ashraf

Ghani’s. Sipas “The Washington Post” nga 352,000 që duhet të ishin forcat afgane, vetëm 254,000 mundet të konfirmoheshin nga drejtuesit ushtarakë.

Sipas “The Guardian”, në një raport që monitoron shpenzimet në konflikte, thuhet se korrupsioni i pamundur për t’u ndalur, u bë “infektues” dhe demoralizues për trupat e sigurisë. Ushtarët nuk i shikonin liderët e tyre si udhëheqës, por si njerëz pa ideal, me vese dhe tradhtarë.

Ideologjia rreth së cilës duhet të bashkoheshin nuk funksionoi tek afganët. Ata nuk ishin besnikë të Atdheut të tyre dhe të qeverisë qendrore, por ishin më shumë besnikë të fisit apo besimit fetar. Afganët nuk e shikonin atdheun si më të rëndësishmin në idealet e tyre, por besimin tek feja madje tek sektet brenda fesë së tyre. Nga ana e tyre talebanët ishin të qartë dhe të bashkuar rreth ideologjisë islame qysh nga 2001 dhe asnjëherë nuk kanë reshtur propagandën e ideologjisë së tyre, për dëbim të pushtuesve nga atdheu i tyre.

Talebanët kurrë nuk u larguan nga përfitimi i fondeve për mbijetesën e tyre. Këto burime nuk u goditën apo ndërprehen asnjëherë nga policia afgane, çka e mbajti gjallë lëvizjen dhe ideologjinë talebane, si dhe vetë ekzistencën e tyre. Sipas Mullah Yaqoob, djali i udhëheqësit të ndjerë shpirtëror të talebanëve, Mullah Mohammad Omar, talebanët fituan 1.6 miliardë dollarë amerikanë gjatë 2020 nga: droga – 416 milionë dollarë me rreth 84% të prodhimit global të opiumit; minierat – 400 milionë dollarë deri në

464 milionë dollarë; minierat e hekurit, mermerit, bakrit, arit, zinkut dhe metaleve të tjera dhe mineraleve të rralla; nga gjobot dhe taksat – 160 milionë dollarë; donacione bamirësie – 240 milionë dollarë; eksportet – 240 milionë dollarë; pasuritë e paluajtshme – 80 milionë dollarë, etj. Në këtë buxhet të konsiderueshëm talebanët, kishin në listëpagesat e tyre edhe një numër të konsiderueshëm të drejtuesve të sigurisë, të infiltruar nga të cilët merrnin inteligjencë, por edhe i përdorën në sulmin e tyre final, për të mundur pa luftë një ushtri 4 herë më të madhe në numër.

Kohezioni mes ushtarakëve dhe sensi i detyrës, betimit dhe sakrificës ndaj atdheut mungonte, duke rritur mosbesimin në lidhshmëri, i cili shkonte deri në presidencën afgane. Kishte edhe teori konspirative në mes ushtarakëve të përhapura me qëllim, që paralajmëronin një marrëveshje të fshehtë midis talebanëve dhe qeverisë afgane. Këto metoda të luftës psikologjike, të përhapura nga talebanët e çorientuan, përçanë dhe goditën përfundimisht kohezionin mes forcave të sigurisë afgane. Ata u demoralizuan deri në pikën e dorëzimit pa armë të të gjithë vendit. Ky mjedis i mosbesimit dhe dyshimit në radhët e ushtarakëve shkonte në të kundërtën e talebanëve të cilët ishin të përkushtuar, të vendosur dhe të motivuar për krijimin e Emiratit Islamik.

Interferimi politik dhe lëvizjet e fundit në ndryshimin e drejtuesve ushtarakë dhe të policisë në ditët e fundit, mendohet të jenë faktorët shtesë në dobësimin e performancës së ushtrisë dhe sigurisë afgane. Para tërheqjes së NATO-s u ndryshuan pa motiv Shefi i Shtabit të ushtrisë afgane, gjenerallejtnant Wali Mohammad Ahmadzai, i cili ishte emëruar në Qershor, me gjeneral major Haibatullah Alizai. U zëvendësua ministri i brendshëm dy herë si dhe u bë riorganizim i forcave të sigurisë duke ndryshuar gjashtë komandantët kryesorë të ushtrisë afgane, brenda tre muajve të fundit. Arratisja jashtë vendit i komandantit të përgjithshëm dhe dorëzimi i shumë gjeneralëve të lartë, ishte pika kulmore e cila vrau çdo shpresë për rezistencë. Kjo situatë ishte çfarë talebanët e përdorën si pretekst për

“bisedime” për “ndryshim paqësor të pushtetit”, dhe marrjen e drejtimit të vendit në kushtet kur komandanti i përgjithshëm është arratisur nga Afganistani.

Talebanët nga ana e tyre ndoqën edhe një strategji tjetër “të zgjuar” fill pas fillimit të tërheqjes së NATO-s. Ata morën nën kontroll pikat e kalimit kufitar, rrugët kryesore, si dhe izoluan Kabuln nga qytetet e tjera, me qëllim pamundësimin e ndihmës dhe izolimin nga qeveria qendrore. Shumë reparte të ushtrisë u shkëputën nga qendra dhe u detyruan me forcë ose të arratisen jashtë vendit ose të dezertojnë ose të pranonin të vriteshin.

Shpejtësia e rimarrjes së kontrollit të Afganistanit nga Talebanët, ka dalë disi edhe jashtë vlerësimeve të inteligjencës amerikane dhe të NATO-s, të cilët parashikonin nga disa javë deri në disa muaj, marrjen e kontrollit të vendit nga ky grup, pasi

konflikti i tejzgjatur, dhe që ka humbur durimin, besimin dhe shpresën për ndryshim të jetesës së tyre, nga qeveria e fundit afgane sot në arrati. Kështu populli i tradhtuar nga lidhshmëria, bëhet i gatshëm të ripranojë këtë regjim”.

Edhe pse nga SHBA-të u shpenzuan jetë njerëzore, kohë dhe para të panumërta për të rindërtuar sigurinë zyrtare shtetërore në Afganistan, pati vetëm një përpjekje rezistence midis tre luftëtarëve të mirënjohur fisnorë: Atta Muhammad Noor of Jamiat-e-Islami, Abdul Rashid Dostum of Hezb-e-Junbish dhe Haji Muhammad Muhaqiq of Hezbe-e, të cilët u përpoqën në Mazar i Sharif të bashkojnë forcat me ushtrinë afgane për një front të vetëm kundër talebanëve. Edhe kjo rezistencë u thye me rënien e Mazar i Shafif, dhe këta luftëtarë u detyruan të arratisen jashtë Afganistanit.

Rënia e ushtrisë dhe sigurisë



nuk pritej arratisja e presidentit, komandantit të përgjithshëm, Ghani. Si rezultat i kësaj “surprize” shumë të huaj janë akoma edhe sot të pa evakuuar për në vendet e tyre, pasi nuk kanë menduar asnjëherë se kjo që po ndodhë kaq shpejt, do të ishte e mundur. Lisa Maddox, një ish analiste e CIA-s shkruan: “Nuk është i papritur rezultati i fitores së talebanëve, pasi ata kanë treguar aftësinë e tyre, për t’u ngritur nga humbjet që kanë pësuar, shtu këtu edhe popullsinë e lodhur, varfëruar dhe demoralizuar nga

afgane, madje edhe para largimit të trupave amerikane dhe të NATO-s, u bë më e rëndë dhe më komplekse nga lirimi i disa mijëra luftëtarëve të “Al Qaida”-s dhe grupeve të tjera terroriste, që mbaheshin të burgosur në bazën ajrore të Bagramit. Ky zhvillim, bashkë me ndërhyrjen, njohjen dhe mbështetjen ndaj talebanëve të disa shteteve të tjera në Afganistan, ditët e fundit vlerësohet se do të sjellë zhvillime, pasoja dhe sfida të tjera të paparashikuara në Afganistan dhe gjeopolitikën përreth dhe përtej tij.

Forcat e Armatosura angazhim maksimal në terren në luftë me zjarrin

